



KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO

# BULETINI

Maj, 2004 Nr.5

№	Titulli i Dokumentit	Titulli i Dokumentit	Titulli i Dokumentit	Titulli i Dokumentit	Titulli i Dokumentit	Titulli i Dokumentit
10.	Kuvendi i Kosovës	10004	10004	10004	10004	10004
11.	Kuvendi i Kosovës	10005	10005	10005	10005	10005
12.	Kuvendi i Kosovës	10006	10006	10006	10006	10006
13.	Kuvendi i Kosovës	10007	10007	10007	10007	10007
14.	Kuvendi i Kosovës	10008	10008	10008	10008	10008
15.	Kuvendi i Kosovës	10009	10009	10009	10009	10009
16.	Kuvendi i Kosovës	10010	10010	10010	10010	10010
17.	Kuvendi i Kosovës	10011	10011	10011	10011	10011
18.	Kuvendi i Kosovës	10012	10012	10012	10012	10012
19.	Kuvendi i Kosovës	10013	10013	10013	10013	10013
20.	Kuvendi i Kosovës	10014	10014	10014	10014	10014
21.	Kuvendi i Kosovës	10015	10015	10015	10015	10015
22.	Kuvendi i Kosovës	10016	10016	10016	10016	10016
23.	Kuvendi i Kosovës	10017	10017	10017	10017	10017
24.	Kuvendi i Kosovës	10018	10018	10018	10018	10018
25.	Kuvendi i Kosovës	10019	10019	10019	10019	10019
26.	Kuvendi i Kosovës	10020	10020	10020	10020	10020
27.	Kuvendi i Kosovës	10021	10021	10021	10021	10021
28.	Kuvendi i Kosovës	10022	10022	10022	10022	10022
29.	Kuvendi i Kosovës	10023	10023	10023	10023	10023
30.	Kuvendi i Kosovës	10024	10024	10024	10024	10024
31.	Kuvendi i Kosovës	10025	10025	10025	10025	10025
32.	Kuvendi i Kosovës	10026	10026	10026	10026	10026
33.	Kuvendi i Kosovës	10027	10027	10027	10027	10027
34.	Kuvendi i Kosovës	10028	10028	10028	10028	10028
35.	Kuvendi i Kosovës	10029	10029	10029	10029	10029
36.	Kuvendi i Kosovës	10030	10030	10030	10030	10030
37.	Kuvendi i Kosovës	10031	10031	10031	10031	10031
38.	Kuvendi i Kosovës	10032	10032	10032	10032	10032
39.	Kuvendi i Kosovës	10033	10033	10033	10033	10033
40.	Kuvendi i Kosovës	10034	10034	10034	10034	10034
41.	Kuvendi i Kosovës	10035	10035	10035	10035	10035
42.	Kuvendi i Kosovës	10036	10036	10036	10036	10036
43.	Kuvendi i Kosovës	10037	10037	10037	10037	10037
44.	Kuvendi i Kosovës	10038	10038	10038	10038	10038
45.	Kuvendi i Kosovës	10039	10039	10039	10039	10039
46.	Kuvendi i Kosovës	10040	10040	10040	10040	10040
47.	Kuvendi i Kosovës	10041	10041	10041	10041	10041
48.	Kuvendi i Kosovës	10042	10042	10042	10042	10042
49.	Kuvendi i Kosovës	10043	10043	10043	10043	10043
50.	Kuvendi i Kosovës	10044	10044	10044	10044	10044
51.	Kuvendi i Kosovës	10045	10045	10045	10045	10045
52.	Kuvendi i Kosovës	10046	10046	10046	10046	10046
53.	Kuvendi i Kosovës	10047	10047	10047	10047	10047
54.	Kuvendi i Kosovës	10048	10048	10048	10048	10048
55.	Kuvendi i Kosovës	10049	10049	10049	10049	10049
56.	Kuvendi i Kosovës	10050	10050	10050	10050	10050
57.	Kuvendi i Kosovës	10051	10051	10051	10051	10051
58.	Kuvendi i Kosovës	10052	10052	10052	10052	10052
59.	Kuvendi i Kosovës	10053	10053	10053	10053	10053
60.	Kuvendi i Kosovës	10054	10054	10054	10054	10054
61.	Kuvendi i Kosovës	10055	10055	10055	10055	10055
62.	Kuvendi i Kosovës	10056	10056	10056	10056	10056
63.	Kuvendi i Kosovës	10057	10057	10057	10057	10057
64.	Kuvendi i Kosovës	10058	10058	10058	10058	10058
65.	Kuvendi i Kosovës	10059	10059	10059	10059	10059
66.	Kuvendi i Kosovës	10060	10060	10060	10060	10060
67.	Kuvendi i Kosovës	10061	10061	10061	10061	10061
68.	Kuvendi i Kosovës	10062	10062	10062	10062	10062

Deri tash në Kuvendin e Kosovës janë proceduar 68 projektligje, nga të cilët 35 janë aprovuar dhe nënshkruar nga PSSP-ja , ndërsa 33 të tjerë gjenden në faza të ndryshme shqyrtimi.

KRYEPARLAMENTARI DACI PRITI PRESIDENTIN  
E SHQIPËRISË, ALFRED MOISIU

## Zhvillimet në Kosovë reflektohen në gjithë rajonin



**T**razirat e marsit ishin të padëshiruara, por ato nuk duhet ta pengojnë Kosovën të ecë përpara në rrugën e saj, ka thënë Presidenti i Shqipërisë, Alfred Moisiu, në takim me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci. Në këtë takim të ngrohtë, në të cilin merrnin pjesë parlamentarë shqiptarë, stafi i presidentit, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe shefat e grupeve parlamentare, profesor Daci e ka vlerësuar tepër të rëndësishme për Kosovën vizitën e presidentit Moisiu, kurse qëndrimin e tij për rrugën demokratike dhe paqësore të Kosovës, shumë të pranueshme nga kosovarët.

Presidenti Moisiu ka vlerësuar punën e Kuvendit të Kosovës në këtë legjislaturë, por është shprehur se zhvillimet pozitive që priten, kërkojnë angazhim edhe më të madh. Ai është shprehur se zhvillimet në Kosovë reflektohen në gjithë rajonin, prandaj duhet pasur kujdes që të mos përsëriten trazirat e marsit. Moisiu i ka quajtur shqiptarët faktor të rëndësishëm të paqes në Ballkan dhe është shprehur optimist për ardhmërinë, por ka tërhequr vërejtjen se zvarritja e statusit të Kosovës mund të riprodhojë tensione me pasoja largvajtëse. Miqtë krijohen vështirë, por humben lehtë, është shprehur presidenti shqiptar duke aluduar në rëndësinë që kanë raportet e mira me ndërkombëtarët.

Moisiu ka folur edhe për tolerancën fetare të shqiptarëve që nuk përkon me dhunën e manifestuar ndaj objekteve të kultit gjatë trazirave të fundit dhe ka kërkuar që të zbardhen faktet për to, sepse është shprehur i bindur se nuk ishin në interes të Kosovës dhe të shqiptarëve.

Kryeparlamentari Daci në fund të takimit e ka ftuar presidentin Moisiu dhe shoqëruesit e tij për një kafe në holin e Kuvendit, pas së cilës e kanë vizituar edhe sallën e renovuar të Kuvendit.



### PËRMBAJTTJA:

<b>Heronj të Kosovës janë ata që dëshirojnë ta ndërtojnë një shoqëri të re - me të ardhme në Evropë.....</b>	<b>9</b>
<b>Miratimi i kodeve- e arritura më e madhe.....</b>	<b>17</b>
<b>Është krijuar baza ligjore, hulumtohen rrugët e sigurimit të mjeteve .....</b>	<b>20</b>
<b>Gatishmëri për të përballuar gjendjen dhe qëndruar në rrugën evropiane të Kosovës.....</b>	<b>14</b>
<b>Të drejta të plota për minoritetet, por jo ndarje apo kantonizim të Kosovës.....</b>	<b>16</b>
<b>Bujqësia kosovare nuk gëzon masa subvencionuese.....</b>	<b>13</b>

### Redaksia:

**Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu**

Telefonat Kontaktues:

**038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921**

Tel/Fax: **038 211 188**

**E-mail:**

[media@assembly-kosova.org](mailto:media@assembly-kosova.org)

**Web faqja:**

[www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

# Gatishmëri dhe angazhim për mbrojtje të pakicave dhe të pronës së tyre

*Është përgjegjësi jona që të dënojmë demonstratat e dhunshme si metodë dhe mjet i palejushëm dhe i padobishëm në shoqërinë demokratike, kur kemi institucionet legale dhe legjitime të zgjedhura me votën e lirë të popullit. Kosova, në të kaluarën, ka pësuar shumë dhe është humbje e madhe për familjarët dhe për Kosovën tonë të vogël humbja e kaq shumë jetërave në këto dy ditë*

Më 25 mars vazhdoi seanca e ndërrprerë e Kuvendit të Kosovës pas trazirave të 17 dhe 18 marsit, e cila në rend dite kishte gjendjen aktuale në Kosovë. Duke iu drejtuar deputetëve kryetari i Kuvendit të Kosovës **Nexhat Daci** theksoi: "Ngjarjet e dhunshme dhe të dhembshme të 17 dhe 18 marsit na kanë mbledhur që ne, në këtë seancë plenare të Kuvendit të Kosovës, të organit më të lartë të zgjedhur nga populli i Kosovës, ta analizojmë gjendjen dhe të marrim drejtime që janë në të mirë të Kosovës, në të mirë të popullit të saj dhe të të gjithë qytetarëve, pa dallim.

Ne si Kuvend, për të qenë në nivel të përgjegjësi dhe detyrave tona, duhet njëzërit të dënojmë dhunën e përdorur në këto demonstrata, sulmet në popullsinë serbe dhe atë hashkalinj, të dënojmë djegien e pasurisë së qytetarëve serbë e hashkalinj të Kosovës, të kishave dhe të objekteve të tjera.

Kuvendi i Kosovës do të përkrahë Qeverinë e Kosovës, të zgjedhur prej tij, që në afat sa më të shkurtër të sanohen dëmet dhe të rindërtohen shtëpitë e objektet e djegura dhe të shkatërruara. Kjo është përgjegjësi dhe obligim yni. Jo nga ndjenja e fajit, por nga obligimet që dalin si institucione përgjegjëse për gjendjen e përgjithshme dhe për përkujdesjen ndaj të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallim përkatësie kombëtare, fetare, racore apo përkatësie tjetër.

Fuqimisht i dënojmë sulmet ndaj pjesëtarëve të policisë së UNMIK-ut dhe të KFOR-it, ndaj automjeteve dhe objekteve të misionit ndërkombëtar, i cili ka ardhur në Kosovë në një



mision shumë fisnik – për ndalimin e gjenocidit, për ndërtimin e paqes dhe të institucioneve, që Kosova realisht edhe në vepër të jetë pjesë e Evropës së bashkuar dhe të institucioneve demokratike të saj.

Nga vlerësimet që i bën ngjarjeve ky Kuvend i popullit, ne do të dalim më shpejt apo më ngadalë nga kjo gjendje dhe do të mund t'i kthehemi normalitetit dhe partnerizmit të njëmendët me bashkësinë ndërkombëtare në realizimin e synimeve tona. Edhe pse kemi tërhequr vërejtjen tash e një kohë, demonstratat e 17 dhe 18 marsit na zunë në befasi edhe neve si institucione kosovare, edhe misionin ndërkombëtar në Kosovë. Hulumtimet do të tregojnë se si një demonstratë - me norma demokratike, krejtësisht të ligjshme, me një motiv krejt të qartë të protestimit ndaj mbyjtjes së fëmijëve në lumin Ibër dhe ndaj deblokimit të magjistralës Prishtinë – Shkup u shndërrua në demonstrata të dhun-

shme, me pasoja shumë të rënda.

Organet përkatëse do të hulumtojnë se kush krejt ishte i përzier dhe me çfarë qëllimesh. Një gjë është e sigurt, këto ngjarje sado të rënda, nuk do të na largojnë nga rruga jonë e trasuar tash e sa kohë, nga qëllimet tona në interes të popullit të Kosovës, të rajonit dhe të Evropës. Ne edhe më tej do të insistojmë në punën institucionale, në përgjegjësitë dhe detyrat tona që burojnë nga vota e popullit, do të zhvillojmë një partnerizëm funksional dhe konkret me UNMIK-un dhe bashkësinë ndërkombëtare në mënyrë që ky mision të dalë krejtësisht i suksesshëm dhe të shërbejë si model me përvojën e vet për misionet e ngjashme në botë.

Angazhimi ndërkombëtar, vullneti dhe përkushtimi i popullit tonë do të na bëjnë shumë shpejt një vend demokratik të Evropës. Kjo na stabilizon neve dhe kjo e stabilizon rajonin.

Nuk do të ketë sukses asnjë tendencë

përçarëse, asnjë tendencë e ndarjes së Kosovës, e enklavizimit, e kantonizimit apo e copëtimit të saj. Kosova do të jetë një dhe e tërë, dhe të drejtat e liritë do t'i realizojnë të gjithë qytetarët e saj, pa dallim.

Ne pas kësaj seance do të vazhdojmë me punën tonë të rregullt për miratimin e ligjeve, për të cilët ka nevojë Kosova, me miratimin e të cilëve ne gjithnjë e më shumë do të jemi Evropë.

Në Kryesi dhe me shefat e grupeve parlamentare kemi ndërtuar një plan operativ të vizitës të të gjitha komunave të Kosovës që të sanojmë gjendjen dhe të marrim vërejtjet e propozimet konkrete të institucionalizimit të të gjitha veprimeve në të gjitha nivelet dhe të koordinimit të tyre në interes të qytetarëve të Kosovës.

### **Angazhohemi që pakicave mos t'iu ndodhë ajo që i ka ndodhur shumicës në dekada**

**Alush Gashi**, përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës theksoi se Kosova ka qenë më e mirë para historisë së ditëve të shkuara. Duke riafirmuar të drejtën për protestë, fuqimisht e kundërshtojmë dhunën. Dhuna nuk është përcaktim i shumicës së qytetarëve të Kosovës. Përcaktimi ynë është paqja, barazia dhe shansa e njëjtë për të gjithë.

Këtu jemi përfaqësues të shumicës, andaj shprehim gatishmërinë dhe angazhimin tonë për mbrojtje të pakicave dhe pronës së tyre. Mbrojtja e pakicave është përgjegjësi jona, është pra përgjegjësi e shumicës, por nevojitet edhe vullneti i pakicave. Presim nga pakicat që të angazhohen për të mirë të Kosovës e jo kundër saj. Angazhohemi që pakicave mos t'iu ndodhë ajo që i ka ndodhur shumicës në dekada.

Sot diskutohet për gjendjen në Kosovë pa analizë të ngjarjeve tragjike të javës së kaluar. Kërkojmë informacion zyrtar lidhur me tërë atë që është zhvilluar ditëve të shkuara dhe prezentimi të bëhet këtu në Kuvend, jo për të fajësuar apo shfajësuar dhe për t' i ikur përgjegjësisë, por për të siguruar që dhuna të mos përsëritet.

Kërkojmë që të formohet një komision parlamentar ad hoc për hulumtimin e shkaqeve për tragjedinë e ditëve të shkuara. Nuk jemi indiferentë ndaj ngjarjeve të këtyre ditëve. Jemi të angazhuar për normalizim dhe nuk do të pushojmë përderisa të sigurohemi se të gjithë qytetarët e Kosovës të jenë të sigurt dhe t' i gëzojnë të drejtat e barabarta, si shumica ashtu edhe pakica.

Edhe me këtë rast, ju përkujtoj se njollosja e tërë popullit të Kosovës nga qarqe të ndryshme, është e papranueshme dhe kontraproduktive.

### **Dhuna është e patolerueshme**

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e mori **Hashim Thaçi**, i cili theksoi se zhvillimet e fundit në Kosovë janë shqetësuese. Ngjarje më e dhembshme ishte vdekja mizore e kriminale e tre fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër. Reagimet që pasuan morën jetërat e dhjetëra qytetarëve dhe plagosjen e qindra të tjerëve. U dëmtuan shtëpi dhe objekte fetare. Protestat, për fat të keq, eskaluan në trazira. Midis atyre që protestuan kundër dhunës pati edhe individë që përdorën dhunën. Dhuna është e patolerueshme, prandaj veprimet e atyre që e përdorën janë individuale,

të izoluara, të pajustificueshme dhe krejt të papranueshme për popullin e Kosovës dhe institucionet e saj. Sundimi i ligjit duhet të funksionojë për të gjithë njësoj, por jo sipas standardeve të dyfishta.

Duhet të themi haptas se askush nuk ka të drejtë të fajësojë ose të ndëshkojë një popull të tërë dhe lidërsipin e tij të zgjedhur në mënyrë demokratike për shkak të sjelljes së disa individëve të papërgjegjshëm. Populli i Kosovës nuk është i dhunshëm, por ka halle të mëdha, të cilat kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.

Në vizionin tonë për Kosovën e pavarur dhe sovranë nuk ka vend për njerëz që përdorin dhunën, që mbysin fëmijë, që djegin dhe shkatërojnë pronën e Kosovës.

Ka edhe të atillë që nxitojnë të japin vlerësime të njëanshme për atë se çka ndodhi në Kosovë. Ata tregojnë se nuk janë të interesuar të gjejnë zgjidhje, por vetëm si t' i shpallin fajtorët. Kjo është metodë policore, e papranueshme. Analizat duhet të jenë të përbashkëta, jo të njëanshme, jo të nxituara. Qëndrimet policore nuk mund të shndërrohen në vlerësime politike për institucionet e Kosovës. Jemi ngopur të gjithë me arsyetime e hedhje të fajit ndaj njëri-tjetrit. Askush nuk do t' mund t' i ikë

**Kërkesat e fundit të protestave në Kosovë duhet t' i sqarojmë sakt. Kanë kaluar nëpër faza të ndryshme. Është shumë e saktë që si revoltë e mbyjtjes së fëmijëve kanë filluar protestat, po ato kanë pasur një ngritje brenda dy ditëve në faza të ndryshme dhe faza e fundit ka qenë kërkesë e kulluar politike. Dhe këtu duhet të thuhet ajo. Unë nuk po e dëgjoj atë këtu, me përjashtim të një rasti i cili u tha shumë qartë këtu dhe në foltore, që kërkesë e tyre është që të japë dorëheqje Qeveria e Kosovës. Ju lutem shumë! Nuk mund të mos flitet politikisht në Kuvend për kërkesa që janë të kulluara politike. Pse janë kërkesa politike, kjo është normale dhe grupacionet e marrin përgjegjësinë dhe i artikulojnë politikisht. Kjo është në rregull. Ajo që unë dhe filozofia ime politike, kujtoj edhe i një grupacioni politik që i përkas, është që nuk ka nevojë, nuk është mirë – tash as nevojë nuk ka që për shtrimin e kërkesave politike të jepen jetërat e njerëzve në Kosovë, sepse jemi lodhë, jemi mbytë si popull – si shoqëri të derdhim gjak për një kërkesë. Është mëkat, është humbje e madhe t' i humbim 30 vetë e ma shumë për ta artikuluar një kërkesë politike që është krejt legjitime. Këtu është problemi. Nuk ka nevojë të humben jetërat, a të krijohet efekti i dhunës për ta artikuluar një çështje e cila është kërkesë qytetare. Ky është mendimi im. E DYTA. Thuhet “nuk janë të organizuara”! Në fillim mund të kenë qenë spontane, po protestat në Kosovë kanë marrë karakter organizimi, deri tash në kulmin e artikulimit të kërkesës politike. Ka pasur orkestrim! Unë nuk jam këtu të jap vlerësime – për orkestrim. Ku ka orkestrim ka edhe dirigjent! Kush është dirigjenti, unë nuk e di. S' e di as Kuvendi. Sot jo, por besoj se do të dihen. Sepse, deri sot kërkush s' e ka marrë mbi vete për të thënë – ja, unë e kam bërë këtë organizim. (Sabri Hamiti)**



përgjegjësish që i takon. Duhet të kuptohet për të gjithë se Kosova nuk do të shpërblehet për këto zhvillime, por ne nuk duhet lejuar, si përfaqësues legjitim të qytetarëve të Kosovës, që të ndëshkohet perspektiva e vendit dhe e popullit të saj.

Gjithashtu, ngjarjet e fundit nuk përshpejtojnë zgjidhjen e statusit, por duhet punuar që të mos vonohet kjo zgjidhje. E them pa hezitim, se viti 2005 duhet të jetë viti përfundimtar për statusin politik të Kosovës – për pavarësinë e vendit. Në Kosovë ka krizë sociale dhe stagnim, megjithë progresin që kemi bërë në disa fusha. Mbi 60 për qind të qytetarëve janë të papunë, shumica të rinj, pa mundësi për shkollim cilësor, pa mbrojtje adekuate shëndetësore, por mbi të gjitha ende me frikë se çfarë do të sjellë e ardhmja e tyre.

Institucionet e Kosovës janë me gjysmëkompetenca. Çdo nismë e tyre për të shtuar përgjegjësinë për vendin dhe popullin e tyre ngulfatet brutalisht dhe shumë padrejtësisht. Ndërsa, në anën tjetër, lejohet funksionimi i strukturave të paligjshme paralele të një vendi fqinj, të cilat kanë kompetenca aq të mëdha sa që tentojnë të ndajnë një pjesë të territorit të Kosovës dhe për të marrë ligjin në duar të veta. Ata që e financojnë dhe tolerojnë këtë gabojnë rëndë nëse mendojnë se do të pajtohemi me ndarjen e qytetit të Mitrovicës, me kantonizimin ose zyrtarizimin e enklavave.

### **Kosovës mbi të gjitha i nevojitet uniteti politik, qytetar dhe kombëtar**

Por, duhet të jemi edhe vetëkritik.

Institucionet e Kosovës kanë mundur të bëjnë më shumë. Ka edhe të atillë që fshehin mospunën dhe paaftësinë e tyre me mungesë të kompetencave. Ka edhe të atillë që shfrytëzuan institucionet për ta pasuruar veten dhe të afërmit e tyre, pa asnjë fije turpi dhe pendimi.

Mirëpo, tash është koha për të reflektuar se çka ndodhi dhe për t'i riparuar dëmet, duke punuar së bashku dhe kjo që ndodhi të mos përsëritet më kurrë. Duhet ta mbështesim Qeverinë, e cila ka ndarë mjete për sanimin e gjendjes. Pakicat duhet t'i gëzojnë të drejtat e tyre dhe për të jetuar në një Kosovë të lirë e demokratike, të pavarur, dhe të jenë të barabartë pa dallim përkatësie etnike. Nuk duhet lejuar që këto zhvillime të përdoren për beteja politike, sepse Kosovës sot mbi të gjitha i nevojitet uniteti politik, qytetar dhe kombëtar. Statuskuoja nuk i ndihmon askujt. Iu ndihmon vetëm atyre që dëshirojnë ta mbajnë peng perspektivën e Kosovës.

### **UNMIK-u bashkë me institucionet e Kosovës kanë bërë disa gabime në këtë periudhë**

Ne duhet të bëjmë një vijë ndarëse, një vijë të qartë ndarëse në mes të dhunës - në njërin anë, të shfaqur në cilëndo pjesë të Kosovës dhe në çfarëdo forme që është shfaqur ndaj cilitdo qytetar të Kosovës - dhe protestës e të drejtës për të protestuar për një gjendje të krijuar në Kosovë, e cila është e drejtë e garantuar me çdo ligj demokratik, theksoi **Bajram Kosumi** në emër të AAK-së. Qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të demonstrojnë e të protestojnë në

mënyrë të qetë dhe të shprehin bindjet e tyre për zhvillimet në Kosovë. KFOR-i, UNMIK-u, institucionet e Kosovës dhe populli i Kosovës janë faktorët vendimtarë që kanë krijuar progresin në Kosovë tash e pesë vjet. Në Kosovë ka një progres të madh. Por, UNMIK-u bashkë me institucionet e Kosovës kanë bërë disa gabime në këtë periudhë dhe këto gabime janë se është toleruar infrastruktura e qeverive të Beogradit që nga përfundimi i luftës të operojnë nëpër Kosovë. Ne e dimë të gjithë, e di KFOR-i shumë më mirë se ne, e di Policia e UNMIK-ut shumë më mirë se ne se infrastrukturën e qeverive të Beogradit kanë vepruar pandërprerë në Kosovë. Prej vitit 2002, në kohën kur këtu ka qenë Përfaqësuesi Special, zoti Hakerup, në Kosovë është rikthyer edhe politika e qeverive të Beogradit. Kjo politikë e qeverive të Beogradit dhe infrastruktura e tyre kanë luajtur dhe kanë vazhduar ta luajnë rolin nxitës dhe luftënxitës. Këto gabime, si dhe gabimet tjera, të cilat po i përmendi shkarazi si nga aftësia e treguar në bartjen e kompetencave, nga aftësia e treguar, ose bllokimi i procesit të zhvillimit ekonomik të Kosovës, nga mangësia e ndërtimit të një gjyqësie të pavarur dhe të aftë - të gjitha këto kanë rezultuar me një bllokim të procesit të gjithmbarshëm politik dhe ekonomik në Kosovë. Në Kosovë ka ngecje, ka stagnim tash e dy vjet. Dhe, askush nuk duhet të jetë i kënaqur me këtë stagnim.

Do të po përmend vetëm një shembull - në vitin 2003 shkalla e njerëzve të varfëruar deri në ekstrem në Kosovë është rritur 6%. Nuk është zvogëluar, por është rritur. Dhe, nëse kjo shkallë vazhdon kështu të rritet, atëherë qytetari i Kosovës, me të drejtë ka filluar ta humbë besimin në perspektivën e sigurt të Kosovës. Por, mund ta tejkalojmë këtë krizë dhe mund ta tejkalojmë këtë stagnim, nëse KFOR-i, UNMIK-u, institucionet e Kosovës dhe populli i Kosovës të bashkëpunojnë sinjerisht në mes veti dhe nëse vendosim ta zhbllokojmë këtë stagnim të përgjithshëm në radhë të parë, në veçanti do të thotë - UNMIK-u dhe

Mendoj se ky debat, megjithatë duhet të rezymohet disi. Duhet të rezymohet dhe nuk jam që të sjellim konkluzione pa pasur fakte. Pra unë jam akoma i rezervuar që t'i kualifikojmë këto protesta si politike, apo si të organizuara. Këtë megjithatë duhet ta thojnë organet e sigurisë. Parlamenti duhet të gjykojë mbi bazë të atyre fakteve. Insistoj që gjithësesi të bëhet një komision apo dikush t'i rezymoje këto qëndrime dhe ato të përgatiten për seancën ku do të debatohen për çështjen e rendit dhe të sigurisë dhe Kuvendi të dalë prej këtij sesioni të jashtëzakonshëm me konkluzione të qarta. Në qoftë se ne përfundojmë vetëm me këto fjalime të mira, që nganjëherë ngjajnë edhe në retorikë, apo në shablone, atëherë nuk kemi bërë kurgjo. Ne duhet ta mbyllim diskutimin për këtë çështje vetëm kur të kemi fakte relevante për atë çka ka ndodhur në Kosovë dhe kur të bijmë konkluzione, të cilat pastaj edhe Kuvendin dhe Qeverinë do ta obligojnë.

Këtu kishte kërkesa për të formuar këtë komision dhe besoj se do të ishte mirë që ai të fillojë të punojë dhe të përgatitë së paku konkluzionet që do të miratohen në një nga mbledhjet e ardhshme. (Arsim Bajrami)

institucionet e Kosovës duhet të krijojnë një partneritet të ri.

Në emër të bashkësive tjera etnike deputetëve iu drejtua **Gani Sadik**, i cili theksoi se dëshira jonë është që shqiptarët, si shumicë absolute e Kosovës, ta luajnë rolin e babait, të prindit të Kosovës, e ne jemi fëmijët, por mos harroni se edhe ne kemi nevojë për dashuri të babait dhe të prindit.

**Melihate Tërmkoll**i tha se ne nuk do të humbim të ardhmen e Kosovës për asnjë lloj ekstremistësh. Krimet dhe kriminelët duhet të ndëshkohen. Duhet të riparohen dëmet fizike, por edhe procesi politik. Dhe gjithsesi nuk mund të ndalet procesi i njohjes së pavarësisë së Kosovës në tërësinë e saj. Kjo nuk është asnjë lloj shpërblimi për shqiptarët, sikur dëgjohet nganjëherë. Është ekzistenca e vetë Kosovës, është thelbi dhe esenca e sigurisë dhe e stabilitetit për Kosovën dhe për rajonin.

### **Të mos jepen vlerësime të pamatura**

**Arsim Bajrami** shprehu shqetësimin për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe tendencat e tentimit të prishjes së imazhit të Kosovës, sidomos imazhit të krijuar gjatë këtyre pesë vjetëve në Kosovë. Ne e dimë se këto zhvillime të fundit janë të provokuara, këto nuk janë zhvillime të planifikuara të dikujt, të qytetarëve të Kosovës, por të provokuara nga vrasja barabare e tre fëmijëve në lumin Ibër, fakt ky që pastaj reflektoi edhe një pakënaqësi legjitime të qytetarëve, me këto veprime që nuk paraqiten për herë të parë në Kosovë, por që po veprojnë

në mënyrë kontinuele gjatë pesë viteve të fundit. Dhe natyrisht prej një proteste legjitime, të një proteste të arsyeshme kundër këtyre akteve të dhunës ajo u shndërrua në akte të eskaluara të dhunës, të cilat nuk mund të përkrahen dhe të cilat nuk i shkojnë për shtati procesit në Kosovë. Natyrisht ne kërkojmë që analiza e situatës së krijuar të bëhet në mënyrë shumë detaje, që vërtetë të kemi informata adekuate të autoriteteve ndërkombëtare përgjegjëse për rendin dhe sigurinë dhe ne nuk mund të pranojmë vlerësime policore apo vlerësime ditore, por kërkojmë që

një gjenocidi që kemi parë para pesë vjetësh dhe midis disa akteve të dhunës, akte të paartikuluara, që nuk shprehin vullnetin institucional dhe vullnetin e vërtetë dhe të mirëfilltë të qytetarëve të Kosovës. Shpresojmë se faktorët ndërkombëtar do të jenë shumë më të matur me rastin e këtyre kualifikimeve për shkak se në Kosovë nuk ka pasur tentim të spastrimit etnik, sepse po të ndodhë një proces duhet të ekzistojë edhe një qëllim i institucioneve të Kosovës, çfarë ka ekzistuar në kohën kur është provuar dhe është zbatuar politika e gjenocidit. Përkundrazi, dihen qën-



këto vlerësime të bëhen me një bashkëpunim të ngushtë midis strukturave vendore dhe ndërkombëtare. Ne si Kuvend insistojmë në atë që ajo çka ka ndodhur – aktet e eskaluara të dhunës nuk janë vullnet i popullit të Kosovës, nuk janë vullnet i qytetarëve të Kosovës dhe si të tilla ato nuk i ndihmojnë procesit në të cilin po shkon Kosova, përkundrazi mendoj se krijojnë një imazh jo të drejtë dhe një fotografi joreale për Kosovën. Gjithashtu ne kërkojmë që mos të jepen edhe vlerësime të pamatura për atë çka ka ndodhur dhe të mos tentohet të krijohen balance dhe baraspesha në bazë të zhvillimeve të fundit. Kundërshtojmë plotësisht tendencën që dëgjojmë këto ditë se në Kosovë ka ndodhur apo është tentuar një spastrim etnik. Mendojmë se kjo tendencë është shumë e rrezikshme dhe tenton të bëjë një baraspeshë midis

drimet e institucioneve të Kosovës, ato janë tashmë publike dhe unë besoj se faktori ndërkombëtar i di këto.

**Muhamet Kelmendi**, pohoi se me të drejtë u kërkua që nga faktori ndërkombëtar duhet të sillen raporte të drejtpërdrejta në bashkëpunim me institucionet e Kosovës dhe të dihet se cilat kanë qenë shkaqet që sollën deri te ky eskalim. Cilat janë rrethanat ekonomiko-shoqërore dhe sociale që krijuan situatë të paparashikuar dhe të pakënaqshme të qytetarëve që reagojnë në këtë mënyrë. Unë mendoj se nuk duhet pranuar kurrësesi idenë, të cilën e lansuan qarqet të ndryshme se këtu ka pasur spastrim etnik, për dy shkaqe: spastrimi etnik bëhet vetëm në qoftë se kemi institucionet të cilat nxjerrin vendime dhe mekanizma të vetë për të vepruar në drejtim të realizimit të

**Zehra Elezi, apeloj në të gjitha institucionet, popujt e Kosovës, faktorët shoqërorë e politikë ndërkombëtarë e vendës, që t' i gjykojnë këto ngjarje të dhembshme, të cilat do të frenojnë prosperitetin dhe do t' i sjellin dëme të mëdha Kosovës. T' u kthehem detyrave tona, sepse para nesh gjendet rruga e vështirë për kthimin e sigurisë, besimit e tolerancës ndëretnike dhe krijimit të kushteve për kthimin e të gjithë të dëbuarve dhe të shpërngururve kosovarë në shtëpitë e tyre, rruga drejt demokratizimit dhe hyrjes së Kosovës në Evropë.**

spastrimit. Këtu nuk kemi pasur elemente të cilët kanë vepruar në drejtime të tilla. Pra, të gjithë mekanizmat tjerë shtetërorë të Kosovës dhe institucionet ndërkombëtare kanë qenë në mbrojtje të demokracisë, në mbrojtjen e vlerave të krijuara dhe të lirive të çdo qytetari, pavarësisht nga përkatësia nacionale.

**Mark Krasniqi** shprehu mendimin se eskalimi i dhunës është tragjedia me e madhe për paqen dhe stabilitetin në Kosovë e në rajon. Ne i dënojmë rreptësisht të gjitha aktet e dhunës, pa marrë parasysh kush e organizon dhe kush e zbaton atë dhunë dhe kundër kujt drejtohet ajo. Dënojmë vrasjet politike të njerëzve për arsye të përkatësisë së tyre etnike e partiake. Dënojmë djegiet e shtëpive, të kishave dhe xhamive dhe objekteve tjera sakrale. Dënojmë demonstratat jodemokratike, shkatërrimtare me të cilat dëmtohet imazhi i Kosovës dhe ardhmëria e saj. Por, para se gjithash, dënojmë sulmet kundër pjesëtarëve të KFOR-it, përkatësisht të NATO-s, të cilët para pesë vjetësh populli shqiptar i priti me lule, me gëzim e hare që na shpëtuan nga shfarosja totale të cilën e filluan ushtria dhe policia serbe ndaj popullsisë civile para pesë vjetësh. Ata që sot çojnë dorë, hedhin parulla, hedhin gurë dhe plumba kundër këtyre shpëtimtarëve tanë - janë dora e djathtë e politikës serbe antishqiptare, ata janë armiq të dhe tradhtarët e popullit shqiptar, ata janë vrasarë të pavarësisë së Kosovës.

### **Të punojmë për të rritur besimin Qeveri - UNMIK**

Ne si deputetë dhe si Kuvendi i Kosovës dhe në përgjithësi institucionet tona, tha **Xhavit Haliti**, duhet të punojnë për ta rritur besimin në mes Qeverisë dhe UNMIK-ut dhe të punojmë në drejtim të korigjimit të dobësive tona, të dobësive ekzistuese në të kaluarën. E them këtë për faktin se askush nuk ka pranuar deri sot topin në anën e vet. Prandaj, për t'u hapur diçka krejt normale, mendoj se do të duhej të formonim një komision ekspertësh të pavarur, jashtë politikës. Të shihet ku është dështuar dhe ku janë problemet për gjendjen e krijuar në raport me ndërtimin e raporteve me UNMIK-un. Sepse, unë

mendoj se logjika jonë duhet ta pranojë, dhe ashtu është, që me UNMIK-un nuk jemi armiq, por jemi partnerë në qeverisje dhe partner për të gjitha çështjet këtu. Dhe kur them se duhet formuar një komision të pavarur për të hulumtuar dobësitë tona dhe ato t'i konstatojë, mendoj se ky komision duhet të jetë i përbashkët me një komision të pavarur, i cili mund të vijë nga shtetet të cilat janë partnere në ndërtimin e boshtit kryesor të UNMIK-ut dhe ekspertë të propozuar nga institucionet e pavarura të cilët bashkërisht do të punojnë për ta ndërtuar një platformë bashkëpunimi në mes UNMIK-ut dhe Qeverisë dhe për t'i hulumtuar dobësitë që kanë përcjellë këtë partneritet, të cilin askush në Kosovë nuk e ka dashur dhe nuk ka qenë dhe nuk ka shkuar në interes të qytetarëve të Kosovës.

Kur e them këtë, kam parasysh një çështje: që ne jemi politikanë dhe politikanët nuk janë për të kërkuar llogari prej qytetarëve, por qytetarët do të kërkojnë llogari nga ne, sa jemi angazhuar për sqarimin e tyre, sa i kemi fryrë zjarrin dhe sa jemi përpjekur për ndërtimin e institucioneve tona dhe të një politike të pranueshme për të gjithë. Thamë se duhet t'i japim llogari atyre, sepse në rend të parë qytetarët Kosovës janë viktimë e politikës së keqe, që është ndërtuar deri tash nga institucionet e Kosovës, pa përjashtim. Dhe mendoj se përgjegjësitë janë për politikanët dhe kur s'ka sukses llogaritë duhet t'i japin të gjithë njësoj, theksoi Haliti .

-Lëvizja Popullore e Kosovës, mendon se protestat kanë qenë spontane si pasojë e dy ngjarjeve të hidhura e që janë të njohura dhe qytetarët e kanë shprehur të gjithë atë lëmsh mllefi të hidhur dhe të formuar nga pakënaqësitë e grumbulluara me gjendjen reale në Kosovë, të cilat protesta në momente të caktuara morën kahje të padëshirueshme dhe të patolerueshme. Mendojmë se statusi i pazgjidhur i Kosovës ka krijuar hapësirë të madhe për mospunë të mirë të institucioneve vendore dhe të UNMIK-ut, duke krijuar mosperspektivë për qytetarët e Kosovës dhe frikë për të një të ardhme më të mirë, pohoi **Hasan Meta**.

**Faik Marolli** tha se komuniteti hashkalinj i ka idetë e përbashkëta me komunitetin shqiptar për Kosovën dhe dihet se kanë punuar dhe do të punojnë së bashku për një jetë më të mirë dhe më të lumtur, për një Kosovë demokratike dhe unike. Fëmijët tanë janë arsimuar nga shqiptarët, ndërsa gjuha, doket, zakonet, kulturat i kemi të përbashkëta. Dua të ceku se edhe ne kemi kontribuar me 3% dhe jemi pjesëmarrës të UÇK- së. Pse kjo ndodhi? Kosova është e të gjithëve dhe në të mund të jetojë kushdo. Por sot, në këtë kohë, hashkalinjt nga Vushtrria jetojnë në tenda me fëmijë e pleq.

**Shefki Sejdiu** duke i vështruar ngjarjet nga konteksti etnopsikologjik zuri në gojë këtë shembull: E kam përcjell varrimin e tre fëmijëve që humbën jetën

**Mendoj se bëmë mirë që debatua të gjithë që janë paraqitur për debat. Tash mbetet që në vazhdim të këtij debati Kryesia, në bashkëpunim me shefat e grupeve parlamentare, të shikojë dhe të marrë një qëndrim për formimin qoftë vetë Kuvendi, qoftë në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës – të një grupi të punës që do të mbledhë informacion për ato që kanë ndodhur, mbështetur mbi bazën e diskutimeve që janë bërë sot në Kuvendin e Kosovës dhe do të krijojë një rezymë apo një analizë të asaj shtate që ka ndodhur javën e kaluar. Është ende e plotëfuqishme ftesa që Kryesia e Kuvendit i ka bërë zotit Hollkeri, zotit Kamerhof, kryeministrit të Kosovës që të vijnë dhe prezentojnë në seancë plenare për një kohë më të gjatë dhe të kenë mundësi të rrinë e qëndrojnë këtu dhe të dëgjojnë deputetët dhe ne të dëgjojmë prej tyre informacionin e rëndësishëm, të saktë dhe të plotë se çfarë dhe si kanë ndodhë këto çështje. Dhe ne presim që ajo seancë të mbahet dhe ata zotrinj të vijnë këtu dhe ta njoftojnë popullin e Kosovës për ngjarjet që kanë ndodhur. Të gjitha këto, edhe të parat dhe këto qëndrime do të qartësohen në Kryesi në bashkëpunim me shefat e grupeve dhe ju do të njoftoheni dhe do të votoni për to. (Bajram Kosumi)**

në ujërat e Ibrit. Aty ishte një përcjellje aq stoike, aq denjtoze. Ishte një dramacitet i dhembshëm. E përçolla dje reagimin në Fushë-Kosovë, se me çfarë histerie e çfarë tragjike u shprehnin aty! Këtë duhet, ata që hulumtojnë këto gjëra, mirë t'i peshojnë.

Të mos veprohet me paragjykime, të mos dënohet një popull i tërë për ekscese që ndodhin gjithkund. Pashë, dhe këtë po e shpreh unë këtu haptas se ne duhet të na shqetësojnë jomatunitë, duhet t'na shqetësojnë trazirat e këtij tipi, por nuk mjafton vetëm të na shqetësojnë. Duhet të punojmë në këtë pikëpamje.

Komuniti hashkalinj, vlerësoi **Sabit Rrahmani**, e di mirë që 99% të shqiptarëve e ndoshta edhe më shumë prej tyre nuk e ka dëshiruar një situatë të tillë. Si hashkalinj e dimë shumë mirë që kjo situatë dhe kjo dhunë që ka eskaluar më 17 dhe 18 mars me siguri se nuk do të ndikojë në statusin përfundimtar të Kosovës, por do të ndikojë në zbatimin e standardeve për zhvillimin e një shoqërie demokratike në Kosovë. Ta lëshojnë shtëpinë 5 vjet pas luftës, është çudi! Këta banorë vetëm dy vjet pas luftës janë kthyer në vatrën e tyre, ndërsa tash janë larguar nga një grup qytetarësh të pandërgjegjshëm – 70 apo 80 prej tyre. I falënderoj shumë Kuvendin Komunal të Vushtrrisë dhe pikërisht deputetin Ibish Jonuzaj, me të cilin jemi takuar këto ditë që komuniteti hashkalinj e ka përkrahjen e kuvendit komunal dhe institucioneve tjera të Kosovës duke u bazuar edhe me vetë vizitën që ia ka bërë kryeministri.

**Smajl Latifi**, tha se protestat, pavarësisht që ishin shprehje e revoltës popullore, ishin të paorganizuara, me elemente dhune dhe megjithatë ishin produkt i gjendjes së rëndë politike që mbretëron në Kosovë, ato ishin të diktuar nga pozitat juridike, administrative dhe para se gjithash politike e Kosovës. Protesta prishi statuskuon në Kosovë dhe dëshmoi se sa është e madhe forca e një populli që ngritet në këmbë. Athua vallë a e dinim këtë forcë në politikanët, klasa politike. A thua vallë e njihnin forcën e popullit të tyre krerët e bashkëqeverisjes në Kosovë? Populli me këtë rast u ngrit

dhe e dënoi edhe një herë një politikë që dështoi në këto drejtime.

Demokracia e mirëfillt nënkupton barazi qytetare për të gjithë, pohoi Sala Ahmeti. Athua ishte kështu në Kosovën e traumatizuar? Jo. Oferta e institucioneve të Kosovës vendore dhe ndërkombëtare kundruall qytetarëve tanë ka qenë abstrakte.

**Sylejman Çerkezi** tha se janë tre faktorë kryesorë të cilët kanë ndikuar në gjendjen që ndodhi këto ditë dhe ai është faktori vendor, faktori UNMIK dhe absolutisht shteti fqinj si faktor në vetë.

**Drita Statovci** vlerësoi se ndodhën veprime tipike për realitete të tilla,

por ndodhën edhe veprime atipike dhe akulturore. Dhe të gjitha këto, në një vend, në një kohë dhe në një popull që pas shumë sakrificave të kohës më të re, por edhe të sakrificave shekullore e të pandërprera - me luftën e vet dhe me ndihmën shumë-domethënëse të NATO-s e të ndërkombëtarëve të tjerë arriti që tani e pesë vjet të jetojë i lirë. Ky popull që megjithë forcën e vet dhe me ndihmën e ndërkombëtarëve gjithnjë bën përpjekje për një jetë më të mirë, për një shoqëri demokratike, për drejtësi e rend për të gjithë që jetojnë në këtë hapësirë – tani si duket, i nxitur – u trazua. Kosova u trondit dhe bota u nevrkos dhe u zhgënjye.

#### MBLEDHJE E KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR MEDIA

### Raportimi për protestat e marsit në Kosovë ishte i paanshëm dhe korrekt

**K**omisioni për media i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Sabit Rrustemi, vazhdoi shqyrtimin e Raportit të Komisionerit të përkohshëm për media, Robert Gillette, lidhur me prezantimin e protestave të marsit në televizionet e Kosovës. Në këtë bashkëbisedim ishin ftuar kryeredaktorët e tri televizioneve të Kosovës me shtrirje kombëtare ( RTK, KTV dhe TV 21). Në këtë mbledhje ishte ftuar edhe Komisioneri Robert Gillette, por ai nuk mori pjesë, meqë ishte angazhuar në një takim tjetër.

Përfaqësuesit e mediave elektronike ishin unanim në vlerësimet e tyre se raportimi për protestat e marsit në Kosovë ishte profesional, i paanshëm dhe korrekt. Është e vërtetë se ka pasur disa raporte joprofesionale nga terreni, por ato nuk u bënë me qëllim të caktuar, madje lëshimet e tilla të vogla nuk ishin substanciale. Kemi raportuar shpejt e në mënyrë të matur, por nuk kemi mundur të fshehim gjërat. Mediat elektronike nuk ndikuan negativisht në ngjarje. Nuk duhet harruar faktin që raportimi nga këto ngjarje u bë në kushte të vështira, kur nuk kishte transparencë nga institucionet vendëse e

ndërkombëtare mbi atë që ndodhte. Në dritën e këtyre fakteve vlerësimet e Raportit të Komisionerit të përkohshëm për media, Robert Gillette, përbëjnë akuza shumë të shpejta, më tepër të nxituara nga befasia e ngjarjeve. Raporti i komisionerit Gillette është i njëanshëm, ai është bërë pa bashkëpunuar me mediat dhe institucionet vendëse.

Në analizat mbi këto ngjarje vërehet tendenca për zhvendosje të fajit, si dhe përpjekja për disiplinimin e mediave. Mbrëtojnë vështrime politike e jo profesionale, theksuan disa diskutues.

U tha se në Raportin e komisionerit Gillette ka gjëra të akceptueshme, sidomos në aspektin e domosdoshmërisë së ngritjes profesionale të gazetarëve, mirëpo kjo është edhe synim i përhershëm i mediave. Në këtë frymë u debatua edhe për qasjen e mediave në sendërtimin e rekomandimeve të Raportit në fjalë. Me theks të veçantë diskutuesit shtruan kërkesën për krijimin e infrastrukturës ligjore në lëmin e informimit, në mbështetje të të cilit më lehtë do të bëhëj edhe vlerësimi i punës së mediave.



# Heronj të Kosovës janë ata që dëshirojnë ta ndërtojnë një shoqëri të re - me të ardhme në Evropë

*E di që kjo dhunë nuk ka qenë vepër e tërë shoqërisë. Ka qenë vepër e një grupi të vogël të njerëzve që e kanë planin e tyre për Kosovën. Plani i tyre është një Kosovë në të cilën ata qeverisin përmes dhunës dhe kërcënimit, duke e mbajtur tërë popullin e Kosovës peng për qëllimet e tyre. Plani i tyre nuk e pranon demokracinë, e refuzon sundimin e ligjit, plani i tyre e mohon trashëgiminë e pasur kulturore të Kosovës dhe shumëllojshmërinë etnike, plani i tyre nuk ofron zhvillim ekonomik, ai premtion që Kosova do të jetë e varfër në Evropë, theksoi Hollkeri*



Hollkeri iu drejtohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës

**E**dhe në seancën e 9 prillit të kësaj shtetërisë shqyrtimi ishin trazirat e 17 dhe 18 marsit. Pasi hapi seancën plenare, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci tha se është kënaqësi imja e veçantë që sot në Parlamentin tonë është i pranishëm edhe zoti Hollkeri, përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara e bashkë me të edhe zëvendësi i tij, zoti Brajshou.

Do të kishim dashur të kemi një takim vërtetë, të themi, mbas edhe të rëndësishme historike të ishte në kohëra kur do të mund t'i sublimonim sukseset bashkërisht të arritura. Megjithatë, në mënyrë të përzemërt dhe të sinqertë i dëshiroj, edhe në emrin tuaj e të Parlamentit të Kosovës dhe në tërësi të kosovarëve, mirëseardhje në Parlament.

**Zotim për ta shtyer përpara procesin e privatizimit**

Kryeadministratori Hari Hollkeri iu drejtua deputetëve me këto fjalë: "Këto janë ditë të vështira për Kosovën. Tri javë më parë, ne i përjetuam ngjarjet që ishin të tmerrshme dhe tronditëse. Për shkak të dhunës, sot nuk na janë bashkuar përfaqësuesit e bashkësisë serbe, edhe pse vendi i tyre legjitim duhet të jetë këtu, me ne, duke e diskutuar të ardhmen tonë të përbashkët. Mua më vjen keq për këtë.

Jam këtu me ju ta bëjmë një vlerësim, të mendojmë për përgjegjësitë tona, të mësojmë dhe të ecim përpara. Ne mund ta bëjmë këtë vetëm së bashku.

Gjatë dy ditëve të dhunës brutale, u shuan 19 jetë, u shkatërruan 730 shtëpi, 29 kisha dhe manastire, shumë prej tyre të mbajtura gjallë si trashëgimi kulturore e gjithë njerëzimit, u dëmtuan dhe u shkatërruan, dhe më shumë se 4000 njerëz të Kosovës u dëbuan nga

shtëpitë e tyre. Unë bashkëndej me të gjithë ata që kanë vuajtur gjatë këtyre ngjarjeve të tmerrshme, duke i përfshirë edhe familjet e fëmijëve të gjorë që u mbytën në Mitrovicë. Ju shpreh ngushllime familjeve të atyre që e humbën jetën në këtë dhunë të pakuptimtë. Populli i Kosovës e njih dhe hidhur nga përvoja e tij e hidhur dhe freskët. Dhuna e vitit 1999 e shtyri bashkësinë ndërkombëtare t'i ndihmojë popullit të Kosovës të shpëtojë nga ajo tragjedi. Dhe tani, dhuna po përsëritet dhe po kërcënon ta shkatërrojë investimin e popullit të Kosovës dhe të miqve të tyre ndërkombëtar, vetëm pesë vjet më vonë.

Unë i kam vizituar vendet e shkatërruara, kam biseduar me viktimat dhe kam biseduar me popullin e Kosovës. E di që kjo dhunë nuk ka qenë vepër e tërë shoqërisë. Ka qenë vepër e një grupi të vogël të njerëzve që e kanë planin e tyre për Kosovën. Plani i tyre është një Kosovë në të cilën ata qeverisin përmes dhunës dhe kërcënimit, duke e mbajtur tërë popullin e Kosovës peng për qëllimet e tyre. Plani i tyre nuk e pranon demokracinë, e refuzon sundimin e ligjit, plani i tyre e mohon trashëgiminë e pasur kulturore të Kosovës dhe shumëllojshmërinë etnike, plani i tyre nuk ofron zhvillim ekonomik, ai premtion që Kosova do të jetë e varfër në Evropë. Ata nuk duhet të lejohen ta realizojnë planin e tyre. Duke punuar së bashku ne do t'ua prishim planet atyre. Dhuna, pavarësisht nga motivi, kushdo qoftë viktimë, duhet

të dënohet, patjetër. Ata që e ushtrojnë atë duhet të ballafaqohen me ligjin; ata që e nxisin atë, duhet të izolohen plotësisht.

Udhëheqësit e vërtetë të Kosovës e dinë këtë. Ata tashmë kanë vepruar për t'iu treguar viktimave të dhunës se njerëzit e denjë dhe të përgjegjshëm të Kosovës do t'i riparojnë dëmet fizike që u janë shkaktuar shtëpive dhe vendeve të kultit.

Udhëheqësit e vërtetë të Kosovës, po ashtu e dinë që dëmi që i është shkaktuar shpirtit të Kosovës duhet të riparohet. Ata tashmë po e japin një porosi për pajtim dhe rindërtim të harmonisë shoqërore.

Unë propozoj që në ditët e ardhshme ta organizojmë një takim të udhëheqësve politik, të Qeverisë dhe të UNMIK-ut për t'i diskutuar hapat praktik për ta filluar rindërtimin e besimit të humbur ndërmjet bashkësive këtu.

Ne në UNMIK, ju këtu në Kuvend, udhëheqësit politik dhe anëtarët e Qeverisë jemi të bashkuar rreth kësaj. Është vetëm një rrugë përpara që ne të mësojmë dhe të dalim nga kjo fatkeqësi, dhe ajo është duke punuar së bashku. Të gjithë kemi përgjegjësi të cilat duhet t'i kryejmë. UNMIK-u e di rolin e tij. Ne do t'i identifikojmë dhe do t'i sjellim para drejtësisë ata që kanë përdorur dhunë. Hetimet e policisë tashmë kanë rezultuar me raste penale ndaj shumë autorëve të dhunës së marsit. Shumë të tjerë do të gjykohen për krimet e tyre.

Ne duhet të mësojmë nga ajo që ka ndodhur. Do të emërohet një organ për shqyrtim, nën një udhëheqje të pavarur, për ta kontrolluar reagimin e UNMIK-ut ndaj dhunës. Ne do t'i zbatojmë rekomandimet e tij.

UNMIK-u i pranon po ashtu përgjegjësitë e tij për të krijuar mundësi ekonomike të cilën e kërkon tërë populli i Kosovës me të drejtë. Zotohem se do të vazhdoj ta shtyj përpara procesin e privatizimit, si mënyrë për ta plotësuar këtë kërkesë. Do të bëj këtë në bashkëpunim me Qeverinë e

Kosovës.

Rruga e mëtejme prej këtu mund të jetë e vështirë, por është e qartë. Para pesë muajve, u planifikua rruga e ardhshme për Kosovën. Shpallja e datës së rishikimit për vlerësimin e statusit të Kosovës e ka bërë të qartë, si kurrë më parë, drejtimin, një rrugë që është miratuar nga udhëheqësit e Kosovës, Këshilli i Sigurimit, UE-ja dhe nga të gjithë miqtë dhe përkrahësit e Kosovës.

Në dhjetor, unë dhe kryeministri, të shoqëruar nga shumë udhëheqës kosovarë, e ekspozuam vizionin për të ardhmen në "Standardet për Kosovën". Ai vizion është shpjeguar thjesht. Standardet e përshkruajnë një shoqëri demokratike, ku ka sundim të ligjit që i mbron të gjithë qytetarët; respektim të shumëllojshmërisë së pasur kulturore dhe etnike të Kosovës; stabilitet dhe prosperitet që ofron jetë të denjë për të gjithë.

Ky është vizioni ynë për Kosovën. E di që është vizioni i popullit të Kosovës. Është një vizion që kur të plotësohet do ta çojë Kosovën drejt një të ardhme të ndritshme në Evropë dhe në bashkësinë botërore.

Javën e kaluar, kryeministri Rexhepi më shoqëroi në shpalljen e Planit për zbatimin e standardeve. Ky plan i paraqet qartas hapat që duhet t'i ndërmarrim për ta arritur këtë vizion. Plani do të jetë punë e vështirë, por mund të bëhet. Unë e di që udhëheqësit e vërtetë të Kosovës janë po aq të vendosur sa edhe unë që ne duhet të ecim përpara për ta arritur vizionin për Kosovën, të cilën e dëshiron populli i saj.

Nuk e kuptojnë dhe nuk e mbështesin atë vizion të gjithë udhëheqësit e Kosovës. Disa po e përkrahin mostolerancën dhe nganjëherë, madje edhe po iu duartrokasit atyre që e kanë përdorur dhunën.

Disa madje i quajnë këta kriminelë – heronj. Disa prej tyre mund t'i jenë bashkuar rezistencës kundër një regjimi shtypës dhe brutal para vitit 1999. Por ekziston një dallim shumë i madh ndërmjet luftimit të shtypjes dhe sulmimit të të pafajshmëve. Të gjithë duhet ta kuptojmë që këta

njerëz janë duke punuar kundër të ardhmes së Kosovës, kundër popullit të Kosovës. Dhe ata duhet të refuzohen. Heronjtë që i nevojiten Kosovës sot, janë njerëzit që dëshirojnë ta ndërtojnë një shoqëri të re - me të ardhme në Evropë.

Populli i Kosovës do të ketë rast t'i mbështesë ata kur ta zgjedhë Kuvendin e ri të Kosovës, më 23 tetor të këtij viti. Ky do të jetë një sinjal të cilin do ta mirëpresin dhe duartrokasin miqtë e Kosovës.

### **Kosova ende ka shumë miq**

Jam i lumtur të them që Kosova ende ka shumë miq. Vizitat që u bënë pas dhunës së marsit nga Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, nga udhëheqësit e Unionit Evropian, nga Shtetet e Bashkuara, na kanë treguar të gjithëve se ata dëshirojnë të na ndihmojnë të arrijmë vizionin e "Standardeve për Kosovën". Lajmi i zotit Grosman, për një "Grup mbështetës për Kosovën", do të na ndihmojë të ecim drejt asaj dite kur të fillojmë ta konsiderojmë vendin e ardhshëm të Kosovës në Evropë dhe në botë.

Ai vend do të definohet nga ajo se si i arrijmë standardet. Përparimi do ta sigurojë një Kosovë të sigurt dhe stabile, populli i saj do të jetë në paqe, një Kosovë që do të ketë marrëdhënie stabile me fqinjët e saj. Por, nëse nuk ka përparim, do të vazhdojë pasiguria, duke ofruar vetëm të ardhme të zymtë për të gjithë njerëzit e Kosovës. Ka zëra që thonë se është e pamundur që bashkësitë e Kosovës të jetojnë së bashku në paqe. Ata e theksojnë dhunën e marsit dhe shumë akte të dhunës të drejtuar kundër njëres apo tjetres bashkësi. Ata kërkojnë ndarje; ata mendojnë që Kosova e ndarë është e vetmja rrugë përpara.

Ajo është një rrugë e dëshpërimit. Nuk ka të ardhme për askënd, për asnjë bashkësi në një Kosovë të ndarë. Por, ne duhet ta vërtetojmë që vizioni ynë është ai i duhuri duke krijuar fakte pozitive. Faktet pozitive që duhet t'i krijojmë ne janë të përkufizuara mirë. Këto fakte pozi-

tive janë "Standardet për Kosovën". Rruga përpara nuk do të jetë e lehtë. Pothuaj se të gjithë në Kosovë e njohin dhembjen e dhunës. Shumë të tjerë ende e njohin mundimin e varfërisë. Të punuarit së bashku në partneritet është mënyra jonë e vetme për t'u marrë me dhembjen dhe me mundimin e vërtetë.

Porosia ime për ju, porosia ime për tërë Kosovën është që të vazhdojmë të punojmë drejt këtij vizioni. Unë jam partneri juaj. Me bashkësinë ndërkombëtare përkrah, unë ua zgjas dorën juve në mënyrë që të mund ta ndërtojmë së bashku një Kosovë që e dëshironi dhe që ju nevojitet. T'i përvishemi punës.

### **Kosova nuk mund të jetë edhe më teatër eksperimental politik**



**Sabri Hamiti** nga Lidhja Demokratike e Kosovës tha se ngjarjet tragjike të 17 e 18 marsit kishin për pasojë humbje jetësh të

njerëzve dhe shkatërrime materiale, prishje të raporteve ndërmjet njerëzve e komuniteteve, por edhe nxjerrje në shesh, ndonëse në mënyrë agresive, të shumë problemeve në Kosovë.

Ne gjykojmë dhunën si metodë të arritjeve të qëllimeve politike, por kemi në konsideratë kërkesat e arsyeshme të qytetarëve. Prandaj, kërkojmë që puna jonë të mos rrëshqasë në fushatë e propaganda sterile, por të jetë përpjekje për të zgjidhur problemet në Kosovë.

Institucionet e Kosovës duhet të fuqizohen, të marrin autoritetin për zhvillimet e ardhshme edhe në fushë të ekonomisë, të sigurisë, të drejtësisë dhe të përfaqësimit të jashtëm. Veprimet e tyre duhet të bëhen në bashkëpunim me UNMIK-un.

Përfaqësuesit e huaj në Kosovë është mirë të heqin dorë nga skema e përdallimit të përfaqësuesve të vendit me djem të mirë e djem të këqinj,

sepse udhëheqësit e Kosovës mandatin e autoritetin e marrin vetëm nga zgjedhësit e vet dhe qytetarët e Kosovës.

Institucionet e Kosovës nuk mund të fitojnë autoritet vetëm duke kundërshtuar UNMIK-un, por edhe UNMIK-u nuk mund të fitojë autoritet te qytetarët e Kosovës, duke patronizuar deri në ekstrem politikat e institucioneve të Kosovës. Unë mendoj se zgjidhja është në bashkëpunim.

Ngjarjet e përmendura të marsit vetëm sa kanë sipërtheksuar që ritmet e zhvillimeve në Kosovë nuk janë të mira, dhe se duhet të ndërrohen. Kosova nuk mund të jetë edhe më teatër eksperimental politik. Prandaj, ridefinimi i raporteve të UNMIK-ut me institucionin e Kosovës tashmë është bërë domosdoshmëri.

Ne përkrahim Standardet si program zhvillimi për pavarësinë, për Kosovën e zhvilluar e demokratike, me një sistem të njësishtëm e të integruar. Ndryshimet konstitucionale sistemore, pa u zgjidhur statusi qendror, vetëm sa mund të forcojnë pushtetet dhe parapushtetet policentrike, që sot janë bërë pengesat më të mëdha të zhvillimit të Kosovës.

Është e nevojshme të bëhet dallimi ndërmjet kërkesave të arsyeshme të qytetarëve, qofshin ato ekonomike, politike a të një natyre tjetër dhe të mënyrës së artikulimit të tyre. Qytetarëve duhet t'u thuhet kah dhe si po shkojnë. Nuk mund të satanizohet një udhëheqësi, madje një popull i tërë, që artikulon zëshëm interesin qytetar dhe kombëtar.

Qytetarët e Kosovës janë kundër dhunës, janë kundër krimit. Mirëpo, krimi në një shoqëri të organizuar, duhet të ndeshet shumë shpejt me drejtësinë. Ne jemi për shoqëri demokratike, për shoqëri të hapur, me dialog dhe integrim të brendshëm të qytetarëve, me liri dhe shansa të barabarta për të gjithë. Ne jemi për punë, e jo për dhunë.

### **Kriza të menaxhohet me veprim politik**

**Arsim Bajrami**, theksoi se Grupi



Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës përshëndet ardhjen e sotme të Përfaqësuesit special dhe mendon se kjo

është një praktikë e mirë që duhet të ndiqet, meqenëse ne kemi nevojë së bashku për ndërtimin e një partneriteti, pasi që çdo progres, apo çdo ngecje në Kosovë është rezultat i përbashkët.

Mendojmë se ngjarjet që kanë ndodhur në Kosovë kërkojnë një analizë të gjithanshme të shkaqeve e pasojave, dhe mendojmë se ajo analizë duhet të jetë e përbashkët dhe kërkojmë që kriza që është shfaqur në këtë kohë të menaxhohet me veprim politik.

Ne dënojmë dhunën dhe të gjitha aktet kriminale, por jemi të vetëdijshëm se është krijuar një vakum politik që ka mundësuar të rishfaqet një mosbesim i qytetarëve tek institucionet e Kosovës dhe rezultatet që i kanë arritur ato, por edhe te puna e UNMIK-ut. Ne kërkojmë që të vazhdojë një analizë e përbashkët e UNMIK-ut me institucionet e Kosovës për ta analizuar atë që ka ndodhur dhe për të ndërtuar një politikë preventive që kjo të mos ndodhë dhe të mos reciklojë.

Natyrisht, ne duke gjykuar dhunën mendojmë se kjo krizë nuk mund të menaxhohet vetëm me veprime represive, vetëm me burgime, por me një veprim politik, i cili do të merret me thellësinë e shkaqeve dhe që do të krijojë një besim te qytetarët në mënyrë që ata të shohin besimin tek institucionet e Kosovës.

Natyrisht ne angazhohemi që fillimisht institucionet e Kosovës të shqyrtojnë veprimin e deritashëm, rezultatet e arritura dhe ngecjet, dhe domosdoshmërisht sa më shpejt ato të ndërtojnë një politikë shumë më aktive, që do të jetë shumë më progresive në kuptimin e rezultateve. Mendojmë, po ashtu, se duhet të rishqyrtohet edhe politika e

UNMIK-un në segmente kryesore: në veprimin e deritashëm - sa po e realizon politika e UNMIK-ut misionin që ka me Rezolutën 1244 dhe a po shkon Kosova me tempon e paraparë drejt statusit final?

Ne mendojmë se të dy këto segmente kanë pasur ngecje dhe në një mënyrë kanë krijuar dyshim te qytetarët dhe kjo ka mundësuar një shfaqje të paartikulluar të pakënaqësive të qytetarëve.

Ne presim që procesi i implementimit të Rezolutës 1244 të përshejtohet. Të përshejtohet për arsye se mbajtja pezull e Kosovës në këtë gjendje sigurisht se krijon një pasiguri të përgjithshme dhe krijon mundësi që qytetarët, nganjëherë në vend të institucioneve dhe besimit institucional, të kërkojnë rrugë si instrument zgjidhjeje, dhe në këtë drejtim ne kërkojmë nga UNMIK-u që të realizojë funksionet kyçe, pra të mundësojë funksionimin e plotë të pushtetit të tij anëmbanë territorit të Kosovës, pra, ta mbulojë me kapacitetet qeverisëse tërë territorin e Kosovës, të japë sa më shumë shenja që ka një politikë aktive drejt shpërbërjes së strukturave paralele dhe, në mënyrë të pashtyeshme të fillojë të bartë kompetencat dhe t'u japë më shumë besim institucioneve të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës fuqishëm përkrah projektin e Standardeve për Kosovën dhe kërkon nga të gjitha institucionet e Kosovës që të angazhohen fuqimisht për arritjen e rezultateve të mundshme në këto standarde, në mënyrë që viti 2005 të jetë vit i finalizimit të statusit final të Kosovës dhe vit kur bashkësia ndërkombëtare duhet pashtyeshëm të merret me çështjen e pavarësisë së Kosovës dhe çështjen e realizimit të asaj, që është edhe vullneti i shumicës së qytetarëve të Kosovës.

Ne presim që të bëhet një dialog i hapur. Mendoj se ardhja sot e zotit Hollkeri këtu është një shenjë e mirë për një dialog të hapur ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe UNMIK-ut, për ridefinimin e pozi-

cioneve për pjesën pasuese të administrimit ndërkombëtar. Mendoj se kjo është e domosdoshme. Dhe, një bartje e menjëhershme e përgjegjësive tek institucionet e Kosovës do të ishte edhe një ndihmesë për UNMIK-un, që sa më shpejt të realizohet misioni i Rezolutës 1244, pra Kosova dhe populli i saj të përgatiten për zgjidhjen e statusit final. Natyrisht, ne jemi të përkushtuar për një Kosovë demokratike, për një Kosovë të bazuar në vlerat e demokracisë dhe të qytetërimit, për një Kosovë me diversitete etnike, kulturore dhe gjuhësore, por edhe për një Kosovë me përgjegjësi të përbashkëta. Në këtë drejtim ne jemi për një politikë shumë të hapur ndaj minoriteteve dhe ftojmë të gjitha minoritetet, në radhë të parë minoritetin serb, që të fillojë të integrohet brenda institucioneve të Kosovës dhe të bëjë një luftë legjitime në Kuvendin e Kosovës për të drejtat që i takojnë.

Natyrisht, ne jemi të gatshëm që, krahas procesit të përmbushjeve të standardeve, të fillojmë edhe një dialog me minoritetet, në mënyrë që, si shumicë të marrim përgjegjësinë mbi vete rreth të drejtave legjitime të minoriteteve.

Dëshiroj të theksoj se ky Kuvend është i vetëdijshëm për përgjegjësitë që ka dhe ne në pjesën pasuese të mandatit vërtetë duhet të ushtrojmë një politikë shumë më aktive, e cila në një mënyrë do ta rikthejë besimin e qytetarëve, pra jo një politikë që shkon pas zhvillimeve politike, por për një politikë që i paraprin zhvillimeve politike dhe në një mënyrë eliminon çdo mundësi të vakumit që do të krijonte.

Ne angazhohemi që vlerësimi i ngjarjeve dhe ndërtimi i strategjisë për tejkalimin e pasojave të jetë i përbashkët dhe përkrahim formimin e komisionit parlamentar që do të merret me këtë çështje dhe në bashkëpunim me UNMIK-un do të dalë me një vlerësim të përbashkët. Përkrahim, po ashtu, ndërtimin e një strategjie preventive të institucioneve të Kosovës me UNMIK-un, në

mënyrë që këto ngjarje të mos përsëriten.

## **Një gatishmëri e re për të bashkëpunuar me institucionet demokratike të Kosovës**



**Bujar Dugolli** theksoi se Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës çmon sot ardhjen e zotit Hollkeri në Kuvendin e

Kosovës dhe dëshiron ta kuptojë si një gatishmëri të re për të bashkëpunuar me institucionet demokratike të Kosovës.

Ngjarjet e muajit të kaluar na kanë vendosur para disa dilemave se a është Misioni ndërkombëtar në nivel të detyrës, si dhe a kanë bërë institucionet e Kosovës krejt atë që është dashur ta bëjnë për t'i parandaluar devijimet që janë paraqitur kohëve të fundit? Mendimi ynë është se - jo. Nuk është punuar si duhet!

UNMIK-u dhe bashkësia ndërkombëtare ka bërë një punë të mirë kur ka ndihmuar popullin e Kosovës t'i ndërtojë institucionet e Kosovës. Por, UNMIK-u nuk e ka kryer detyrën e vet siç duhet, dhe në të shumtën e rasteve, që nga koha e ndërtimit të institucioneve të Kosovës, është bërë pengesë për funksionimin e mirëfilltë të këtyre institucioneve. Praktika po na tregon se funksionimi kështu, i dy qeverive në Kosovë, nuk mund të vazhdojë. Administrues dhe qeverisës të Kosovës duhet të jenë vetë kosovarët dhe institucionet, të zgjedhura në mënyrë demokratike nga vota e qytetarit.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar me institucionet ndërkombëtare, si brenda në Kosovë, po ashtu edhe jashtë vendit.

Tani ne, institucionet e Kosovës, UNMIK-u dhe KFOR-i nuk mund të



sillemi sikur nuk ka ndodhur asgjë dhe të vazhdojmë me të vjetrën, por duhet të ndërtojmë një partneritet të ri në mes UNMIK-ut dhe institucioneve demokratike të Kosovës, në kuptimin që institucionet e Kosovës t'i marrin të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë për qeverisje dhe UNMIK-u të jetë monitorues dhe këshilldhënës në Kosovë.

Institucionet demokratike të Kosovës duhet të garantojnë më fuqishëm sigurinë dhe barazinë e pakicës serbe, e të pakicave tjera etnike në Kosovë dhe të bëjnë riparimin e dëmeve të shkaktuara gjatë revoltave qytetare në Kosovë, që ndodhën në muajin e kalaur.

Qytetarët e Kosovës kanë qindra halle që nuk po ua zgjidh askush. Prandaj, me të drejtë ata janë të pakënaqur dhe kanë arsye për të protestuar. Mirëpo, ne përsërisim edhe një herë se protestat e dhunshme nuk i mbështesim dhe dhunën e shfaqur në protestat e muajit të kaluar e dënojmë.

Bashkësia ndërkombëtare duhet të garantojë më fuqishëm se statusi final i Kosovës duhet të zgjidhet në rend të parë në bazë të vullnetit demokratik të popullit të Kosovës. Ne nuk mund të punojmë symbyllur dhe duarlidhur. Platforma Standardet për Kosovën duhet të definohet si: "Standardet për pavarësinë e Kosovës dhe integritetin e saj në strukturat evropatlantike". Vetëm mbi këtë angazhim Kosova, por edhe komuniteti ndërkombëtar do të finalizojnë me sukses këtë projekt të përbashkët.

## Nuk dëshirojmë t'i bllokojmë proceset



**Gani Sadik**, shef i Grupit parlamentar të bashkësive joshqiptare dhe joserbe, theksoi se ne pjesëtarët e pakicave të tjera nacionale në Kosovë, nuk dëshirojmë që t'i bllokojmë proceset, ose nxjerrjen e vendimeve në mënyrë

demokratike me shumicë votash, ashtu siç bëhet gjithkund në botën demokratike.

Ne të ardhmen tonë e shohim duke e respektuar njëri tjetrin, pastaj duke pranuar punën institucionale në institucionet dhe organet tona të zgjedhura me votën e lirë të qytetarit, si dhe duke respektuar integritetin territorial të Kosovës.

Vendi ynë është Kosova, fatin tonë dhe të fëmijëve tanë e kemi lidhur me këtë vend, sepse me shekuj kemi jetuar së bashku, fatin e kemi të përbashkët, ndaj të ardhmen tonë të përbashkët e shohim në kornizat e një Evrope të bashkuar demokratike. Vlerësimi i tillë i ngjarjeve të marsit dhe gjykimi unanim nga të gjithë subjektet e Kuvendit të Kosovës dhe institucionet, gjithashtu edhe marrja e obligimeve konkrete për tejkalimin e gjendjes dhe sanimin e pasojave është rruga e vetme që e rikthen besimin dhe jetëson idenë për Kosovën multietnike dhe multikulturale.

Pikë e dytë e rendit të ditës ishte formimi i komisionit anketues, hulumtes, apo hetues për analizën dhe vlerësimin e të gjitha rrethanave dhe shkaqeve që sollën Kosovën në 17 marsin. Lidhur me këtë kryeparlamentari Daci theksoi se Komisionit duhet dhënë, jo vetëm autoritet, se atë e ka pas zgjedhjes, por një përkrahje të fuqishme që komisioni pa asnjë pengesë të kryejë detyrën e vet.

Në të njëjtën kohë, ftoj edhe UNMIK-un dhe të gjitha institucionet tjera që të jenë kooperuese me këtë komision dhe të shpresojmë se për një kohë, të them relativisht të shkurtër, ndoshta pas një muaji, prapë në një seancë plenare të dëgjojmë atë raport.

Në vijim shefat e grupeve parlamentare nominuan kandidatët për këtë komision. Nga LDK u nominuan Alush Gashi dhe Nekibe Kelmendi, nga PDK-ja Hydajet Hyseni, nga AAK-ja Zylfije Hundozi, ndërsa nga grupi joshqiptar dhe joserb Gani Sadik. Propozimi u përkrah nga deputetët .

## KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL I KUVENDIT TË KOSOVËS

### Bujqësia kosovare nuk gëzon masa subvencionuese

Masat stimuluese për zhvillimin e agrokompleksit kosovar janë shumë të ulëta, madje krahasuar edhe me shtetet përreth , siç është Maqedonia. Politika kredituese me afat të shkurtër dhe kamata shumë të larta prej 11- 18 për qind gjithashtu është shumë e pavolitshme. Bujqësia kosovare praktikisht nuk gëzon masa subvencionuese . Në rrjedhat bujqësore po reflektohet negativisht mungesa e masave konkrete në politikën fiskale, e ligjit themelor mbi pronën, si dhe mungesa e mjeteve për financimin e programeve të zhvillimit në këtë lëmë. Të gjitha këto kanë keqësuar gjendjen në agrar, megjithë shpresat se pikërisht bujqësia do të jetë një promotor i zhvillimit të Kosovës. Këto ishin disa nga konstatimet e mbledhjes së Komisionit për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural të Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Tomë Hajdari, kryetar, në të cilën tema themelore shqyrtimi ishin harmonizimi i punëve Parlament- Ministri e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- drejtoratet përkatëse komunale, propozimi për mundësitë e ndryshimit të politikave fiskale në sferën e agrarit, problematika e pylltarisë në Kosovë, si dhe informata për përgatitjet rreth mbjelljeve pranverore. Në mbledhje merrnin pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë të Kosovës.

Duke ndier peshën e kësaj gjendjeje jo të favorshme, Ministria e Bujqësisë tashmë ka përgatitur një material për masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e politikës fiskale në lëmin e bujqësisë. Këto masa , që së shpejti do të jenë në tryezë të shqyrtimit edhe në Qeverinë e Kosovës , që shoqëruar me zvogëlimin e doganave dhe një bashkërendim të angazhimeve të të gjitha subjekteve do të mund të ndikonin që ky lëmë i rëndësishëm të vihet në këmbë të mbara. Përfaqësuesit e Fakultetit të Bujqësisë edhe me këtë rast premtuan se do të jenë krah i fortë në të gjitha synimet zhvillimore të agrokompleksit.



## Gatishmëri për të përballuar gjendjen dhe qëndruar në rrugën evropiane të Kosovës

*Vendosmëri për t'i dënua krimin dhe kriminelët. -Përfaqësuesit serbë të Kryesisë shprehen se institucionet e Kosovës nuk janë të gatshme të marrin përgjegjësitë për revoltat e dhunshme, kurse përvjetorin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë e vlerësojnë vit jubilar i spastrimit etnik të serbëve*  
**SOLANA: Nga takimi po dal më pesimist se kur kam hyrë**



Takimi i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës me përfaqësuesit e UE-së, Solana e Paten

Në takimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës me përfaqësuesin e lartë të Unionit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Javier Solana dhe komisionerin, Kristofer Paten, kryetari Daci dhe shuica e anëtarëve të Kryesisë janë përpjekur që duke treguar gatishmëri për të marrë përgjegjësisë për pasojat e protestave të dhunshme në Kosovë, të shkoqisin edhe shumë elemente që e kanë provokuar revoltën e qytetarëve, por zoti Solana i ka ndërprerë me fjalët se nuk ka ardhë këtu për të dëgjuar fjalime të bukura, por për problemet që kanë ndodhur dhe të shikohen sy me sy. Komisioneri Paten, ndërkaq, është shprehur se don të dijë se sa shpejt do të krijohet fondi i Qeverisë për meremetimin e shtypive, kishave dhe të shkollave të djegura, duke shtuar se nuk ka ardhur me para për ta kryer këtë punë. Kryeparlamentari Daci i ka njoftuar përfaqësuesit e lartë të UE-së se Kuvendi e mbështetë plotësisht fondin e Qeverisë për meremetim dhe se Kryesia e Kuvendit do të ketë takime edhe me udhëheqjet komunale për të ndikuar në përsheptimin e rindertimeve. Anëtarët e kryesisë nga subjektet politike

shqiptare dhe përfaqësuesja e minoriteteve joserbe dhe joshqiptare, shkakun e protestave e kanë parë në ngecjen e procesit politik, shoqëror dhe ekonomik të Kosovës, në kompetencat e vogla të institucioneve të Kosovës, herë-herë të bllokimit, madje edhe të nënçmimit dhe nëpërkëmbjes së tyre. Ata njëri kanë kërkuar që të vazhdojë investimi i përbashkët për Kosovën evropiane, duke kërkuar që demokracia në Kosovë të realizohet në tërë territorin dhe tek të gjithë qytetarët e saj.

Në anën tjetër përfaqësuesit serbë të Kryesisë u shprehen se institucionet e Kosovës nuk janë të gatshme të marrin përgjegjësitë për revoltat e dhunshme, kurse përvjetorin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë e vlerësojnë vit jubilar të spastrimit etnik të serbëve. Ata kërkuar që mos tu jepen përgjegjësi institucioneve të Kosovës deri sa ato të vetëdijsohen dhe tu kalojë obsesioni nacional.

Në fund të takimit shefi për Politikë të Jashtme dhe Siguri i UE-së, Javier Solana u ka thënë troç parlamentare të Kosovës se nga takimi po dilte më pesimist se kur ka hyrë, duke i përkujtuar se këtë përshtypje do ta bartë edhe tek përfaqësuesit tjerë të Unionit Evropian.

KRYEPARLAMENTARI DACI PRITI KRYETARIN E ODËS EKONOMIKE TË KROACISË, NADAN VIDOSHEVIQ

## Interes për bashkëpunim ekonomik dhe investime të Kroacisë në Kosovë

*Daci kërkoj heqjen e vizave*

Bashkëpunimi ekonomik, me theks të veçantë investimet dhe pjesëmarrja në privatizimin e ekonomisë së Kosovës, ishin temat që u biseduan në takimin e sotëm të kretarit të Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci me kryetarin e Odës Ekonomike të Kroacisë, Nadan Vidosheviq, të cilin e shoqëronin kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Ismail Kastrati me bashkëpunëtorë dhe përgjegjësja e Zyrës së Odës Ekonomike të Kroacisë në Kosovë, Iliriana Shehu.

Profesor Daci e ka njoftuar mysafirin me zhvillimet në Kosovë dhe ka biseduar gjerësisht për mundësitë e aktivizimit të resurseve ekonomike dhe njerëzore të Kosovës në funksion të zhvillimit të përsheptuar të Kosovës dhe interesit reciprok për bashkëpunim me Kroacinë. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Vidosheviq ka shfaqur interes për investime në Kosovë dhe për pjesëmarrje në privatizimin e objekteve ekonomike të Kosovës, pavarësisht nga jehona e trazirave të marsit. Duke folur për rëndësinë e rregullativës ligjore në këtë fazë tranzicioni të Kosovës, ndërkaq, ka vlerësuar se anëtarësimi vullnetar në Odën Ekonomike të Kosovës, sipas ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, nuk është zgjidhje stimuluese, sepse kështu mbrohen interesat vetëm të një grupi ndërmarrjesh, kurse për interesa të përgjithshme shteti duhet të krijojë agjenci të cilat financohen me taksa të qytetarëve.

Duke folur për resurset turistike të Kroacisë dhe mundësitë e vogla të kosovarëve për të udhëtuar në Kroaci, për shkak të regjimit të vizave, Daci ka kërkuar që Zagrebi zyrtar t'i heqi vizat për qytetarët e Kosovës.

# Të drejta të plota për minoritetet, por jo ndarje apo kantonizim të Kosovës

**K**ryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, ka pritur një delegacion të Asamblesë të Bashkësisë së Shteteve të Pavarura (ish republikave të BRSS-së), dhe ka biseduar me të për zhvillimet në Kosovë dhe projektet për ardhmërinë. Mysafirët janë interesuar sidomos për shkaqet dhe pasojat e trazirave të marsit në Kosovë, për të drejtat e qytetarëve të përkatësisë kombëtare serbe dhe vizionin e kryetarit të

Kuvendit për Kosovën. Profesor Daci ka folur gjerësisht për pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës dhe në administratën e vendit, që është më e lartë se përqindja në popullsinë e tërësishme të vendit. Ai është shprehur në favor të të drejtave maksimale për banorët serbë të Kosovës, duke apeluar që të kthehen në punët e përditshme të tyre dhe të pushojnë së instrumentalizuari nga refgjimi i Beogradit. Duke folur për trazirat e marsit, Daci ka theksuar se

dëmtimi i pronës dhe i fatoreve serbe gjatë këtyre trazirave nuk është në traditën e shqiptarëve, të cilët tradicionalisht shquhen për tolerancë etnike dhe fetare. Duke iu përgjigjur interesimeve të delegacionit të Asamblesë së Bashkësisë së Shteteve të Pavarura për projektin serb për Kosovën, Daci ka qenë i prerë: Serbët do t'i realizojnë të drejtat e plota të tyre në Kosovën e lirë e demokratike, por Kosova nuk do të ndahet dhe nuk do të kantonizohet.

**PARLAMENTARI I ASAMBLESË SË UNIONIT TË EVROPËS PERËNDIMORE, JOHN WILKINSON NË KUVENDIN E KOSOVËS**

## Të përfundojë me sukses misioni i UNMIK-ut

*Kompetencat dhe përgjegjësit të kalojnë tek institucionet e Kosovës  
Wilkinson: Rruga e Kosovës për prosperitet dhe stabilitet – domosdoshmëri*

**P**arlamentari i Asamblesë së Unionit të Evropës Perëndimore, John Wilkinson, i cili shoqërohej nga këshilltari politik, Foris De Gou, në takim me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, është interesuar për gjendjen në Kosovë, për pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës dhe për të drejtat e qytetarëve

të përkatësisë etnike serbe. Profesor Daci është shprehur se duhet ndihmuar UNMIK-un që ta përfundojë me sukses misionin e tij në Kosovë dhe që institucionet e Kosovës të marrin më shumë kompetenca dhe përgjegjësi për zhvillimin e vendit. Daci ka thënë se jovetëm serbët, por të gjitha minoritetet janë

të përfaqësuar në institucionet e Kosovës në përqindje më të lartë se pjesëmarrja e tyre në popullsinë e gjithmbarshme. Ai është shprehur se për sa i përket stabilitetit të Kosovës, Beogradi, për fat të keq, tek një pjesë e madhe e e serbëve, vazhdon të luajë rol tepër negativ.

Parlamentari i Asamblesë Unionit të Evropës Perëndimore, John Wilkinson është shprehur se kosovarët duhet të marrin përgjegjësitë për politikën dhe vendimmarrjet. Ai ka vlerësuar të domosdoshme rrugën e Kosovës për prosperitet dhe stabilitet, në harmoni me vizionin e Unionit Evropian.

Bashkëbiseduesit janë pajtuar se Kosova duhet të zhvillohet si vend demokratik dhe me të drejta të plota e liri për të gjithë qytetarët e saj, si dhe me raporte shumë të mira me mekanizmat e institucioneve ndërkombëtare në Kosovë.



## Kosova është e kosovarëve dhe ashtu duhet të jetë edhe në të ardhmen

*Është i nevojshëm një bashkëveprim i ngjeshur i vendësve dhe ndërkombëtarëve për eliminimin sa më të shpejtë të pasojave të protestave.- Minoritetet duhet të mbrohen me ligj të posaçëm, theksoi kryeparlamentari Nexhat Daci*

Në kuadër të sendërtimit të planit operativ dhe N zotimeve që u morën në mbledhjen e fundit të Kuvendit të Kosovës për sanimin e gjendjes pas trazirave të 17 dhe 18 marsit dhe institucionalizimin e të gjitha veprimeve në të gjitha nivelet, si dhe të koordinimit të tyre për tejkalimin e gjendjes së krijuar në interes të qytetarëve të Kosovës, një delegacion i prirë nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, vizitoi sot kuvendet komunale të Ferizajt dhe të Gjilanit . Me këtë rast ata u pritën nga kryetarët e këtyre komunave Adem Salihaj e Lutfi Haziri.

Duke evidentuar dëmet që u shkaktuan në objektet serbe të Komunës së Ferizajt, Adem Salihaj theksoi se dëme kanë pësuar disa kisha të besimit ortodoks dhe varrezat serbe. Ai theksoi se është mbajtur një mbledhje e përbashkët e KFOR-it, UNMIK-ut dhe qytetarëve për eliminimin e këtyre pasojave. Salihaj tha se në këtë komunë nuk kishte dëmtime të objekteve e pronave të romëve dhe të ashkalinjve.

Kryetari i Kuvendit të Komunës së Gjilanit , Lutfi Haziri tha se në këtë komunë janë djegur 21 shtëpi të serbëve, ndërsa janë lënduar 15 policë . Në kuadër të masave që janë marrë për eliminimin e pasojave të dëmeve nga protestat, UNHCR po shpërndan ndihma për të dëmtuarit, ndërsa Kuvendi Komunal ka dhënë 10 mijë euro për të ndihmuar serbët e dëmtuar. Haziri njoftoi delegacionin se në këtë komunë jetojnë gjithsej 15 mijë serbë. Të dy kryetarët e komunave theksuan se janë në vazhde punët e komisioneve për vlerësimin e dëmeve nga protestat për të vijuar me masa për sanimin e tyre .

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci duke iu drejtuar pjesëmarrësve në këto takime, dënoi aktet e dhunës kundër pronave serbe dhe të objekteve të kultit të besimit ortodoks, si dhe sulmet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it dhe të policisë . Aktualisht është i nevojshëm një bashkëveprim i ngjeshur i vendësve dhe ndërkombëtarëve për eliminimin sa më të shpejtë të pasojave të protestave. Kosova është e kosovarëve dhe ashtu duhet të jetë edhe në të ardhmen. Profesor Daci theksoi se minoritetet duhet të mbrohen me ligj të posaçëm.

Delegacioni i Kuvendit të Kosovës sot vizitoi edhe Kishën Ortodokse që gjendet në qendër të Ferizajt dhe një kishë në Gjilan .

## Interes i përbashkët për progres të njëmendët në Kosovë

Në takim me ministrin e Britanisë së Madhe për Evropën, Denis Mac Shane, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, vlerësoi ndihmën e madhe të Britanisë së Madhe për lirinë e Kosovës, për procese demokratike dhe në mënyrë të veçantë për qëndrimin konstruktiv në Këshillin e Sigurimit të OKB-së lidhur me Kosovën.

Kryeparlamentari Daci i ka folur fare hapur diplomatit britanik për zhvillimet në Kosovë, për shkaqet dhe pasojat e trazirave të marsit dhe për marrjen sa më parë të kompetencave të institucioneve të vendit në funksion të paqes, të stabilitetit dhe të përparimit gjithpërfëshirës të Kosovës.

Vizitat e tilla ofrojnë optimizëm të bazuar për Kosovën dhe rajonin është shprehur profesor Daci.

KRYEPARLAMENTARI DACI PRITI NJË DELEGACION TË ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS

## Diskutohet programi për kapërcimin e gjendjes së rëndë ekonomike dhe sociale në Kosovë

Çka të bëhet që të tejkalohen ngecja e ekonomisë së Kosovës dhe vështirësitë e akumuluar sociale të popullsisë ishte tema bosht e takimit të një delegacioni të Odës Ekonomike të Kosovës, të kryesuar nga Ismail Kastrati, me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci.

Përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës i kanë përcjellë kryeparlamentarit Daci shqetësimet e komunitetit të biznesit për ngecjen e privatizimit, politikën fiskale, vështirësitë e investimit të kapitaleve, për gjendjen e rënduar sociale, etj. Me këtë rast është folur edhe për programin për këto çështje të Odës Ekonomike që u është dorëzuar udhëheqësve kryesor vendës dhe ndërkombëtarë në Kosovë, dhe të cilën Daci e ka vlerësuar shumë të qartë dhe të mirë.

Në takim është kërkuar mbështetja nga Kuvendi e projektit të prosperitetit ekonomik të Kosovës, sidomos për mbështetjen e sektorit të bujqësisë.



# Miratimi i kodeve- e arritura më e madhe

- Deputetëve të Kuvendit të Kosovës iu shtruam këto tri pyetje :

- Cilat janë të arriturat më të mëdha në fushën e hartimit dhe të aprovimit të ligjeve të deritashme në Kuvendin e Kosovës?
- Sa jeni të kënaqur me dinamikën e deritashme të nxjerrjes së ligjeve?
- Cilat ligje sipas jush duhet të miratohen sa më shpejt nga ana e Parlamentit?

## Ja përgjigjet e deputetëve

### **Nekibe Kelmendi: Kuvendi nuk ka lejuar ngecje në miratimin e ligjeve**

Të arriturat më të mëdha të deritashme në fushën e miratimit të ligjeve janë ato se Kuvendi ka miratuar të gjitha ligjet, të cilat kanë hyrë në procedurë parlamentare



për miratim, pra ka miratuar të gjitha ligjet që janë propozuar për miratim dhe nuk ka lejuar ngecje në këtë drejtim. Megjithatë, konsideroj se e arritura më e madhe është miratimi i Kodit të procedurës penale dhe Kodi penal i Kosovës, Kodi doganor i Kosovës, infrastruktura ligjore nga fusha e arsimit etj.

Personalisht nuk jam e kënaqur me dinamikën e deritashme të miratimit të ligjeve nga fushat e përgjegjësisë që ka Kuvendi i Kosovës, megjithë faktin se një ndër përgjegjësitë më të rëndësishme të Kuvendit është pikërisht miratimi i ligjeve. Ngecja në miratimin e ligjeve është pasojë e vonësës tejet të madhe të konstituimit të Kuvendit të Kosovës dhe e institucioneve të dala nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, e cila ia ka "harxhuar" kësaj legjislature 1/6 e mandatit të saj. Nga ana tjetër, edhe Qeveria nuk ka qenë efikase në hartimin e draftligjeve, përkatësisht propozimin e ligjeve për miratim, gjë që vërtetohet nga mesatarja tejet e ulët e propozimeve të numrit të ligjeve të shqyrtuara në seancat e Kuvendit. Po kështu, edhe komisionet e Kuvendit kanë qenë shumë

inerte në hartimin dhe propozimin e ligjeve. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për komunitetin e juristëve profesionistë për hartimin e ligjeve, të cilët, me disa përjashtime, nuk kanë ofruar ndihmën e pritur për hartimin e ligjeve. Dhe në fund, refuzimi i nënshkrimeve si dhe kthimi i disa ligjeve në rishikim nga ana e PSSP-së, me pretekst se prej-udikonin statusin final të Kosovës, kthim që është bërë në ndikimin e një grupi parlamentar, pa mbështetje ligjore në Kornizën Kushtetuese, sepse dihet në ç'mënyrë mund të pranohet shteti i Kosovës, përkatësisht pavarësia, i ka penguar institucionet e Kosovës, sidomos sistemin gjyqësor, në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe ka prolonguar hyrjen në fuqi dhe fillimin e zbatimit të ligjeve të miratuara.

Duhet të miratohen të gjitha ato ligje të cilat janë propozuar për miratim, meqë pa propozime nuk mund të ketë as miratime të ligjeve. Ndërkaq, prioritet për hartimin, propozimin dhe miratimin e ligjeve janë: Ligji për të miturit, Ligji për gjykatat, Ligji i procedurës kontestimore, Ligji i procedurës administrative, Ligji mbi pronën, Ligji mbi marrëdhëniet detyimore, Ligji mbi drejtatat e minoriteteve, Ligji mbi pushtetin lokal, Ligji mbi zgjedhjet dhe sa më shumë ligje nga fusha e shërbimeve publike.

### **Berat Luzha: Nuk mund të jemi të kënaqur me dinamikën e miratimit të ligjeve në Kuvendin tonë**

Miratimi i ligjeve në Kuvendin e Kosovës ka filluar para dy vjetëve. Gjatë kësaj kohe janë miratuar mbi 50 ligje, që janë shumë pak. Ligjet janë sponsoruar kryesisht nga Qeveria e Kosovës, respektivisht

nga ministrinë dhe kryeministria, kurse vetëm katër prej tyre janë përpiluar nga komisionet e Kuvendit dhe asnjë nga deputetët apo grupet e deputetëve.



Sigurisht se nuk mund të jemi të kënaqur me dinamikën e miratimit të ligjeve në Kuvendin tonë, kur dihet mungesa e tyre, si edhe nevojat e Kosovës për ligje. Qeveria, e cila ende si duket gjendet në konstituim e sipër, nuk ka qenë edhe aq produktive sa i takon bërjes së ligjeve. Kuvendi i Kosovës, nga ana e tij, mban mbledhje të rralla, të ashtuquajtura sesione, duke lënë që propozimligjet të grumbullohen dhe që pastaj ato të miratohen shkel e shko.

Brengos edhe zvarritja e ligjeve në procedurë. Ndodh që një ligj të përpilohet gjatë shumë muajve, apo edhe me vite të tëra. Kalimi në procedurë nga Qeveria e deri te Kuvendi, që janë në të njëjtën ndërtesë, mund të zgjasë deri në shtatë muaj! Disa ligje nuk përgatiten mirë dhe kështu nxjerrin probleme gjatë amendamentimit nëpër komisione, kurse ndonjëherë edhe komisionet ndërhyjnë edhe pa arsye, duke e dëmtuar apo duke e ndryshuar edhe përmbajtjen apo thelbin e ligjit.

Janë shumë ligje, të cilat duhet të vijnë me përparësi në Kuvend, por dalloj ato që normojnë statusin e kategorive të rrezikuara të popullsisë, sidomos ato për familjet e dëshmorëve, për invalidët e veteranët e luftës të UÇK-së, për të pagjeturit,

për të burgosurit politikë, për pensionistët etj. Me interesim priten edhe propozimligjet për pronën, për pushtetin lokal, kundër korrupsionit, për mediat, për planifikimin hapësinor, për tokën bujqësore etj.

### **Haki Shatri: Qeveria duhet të përqendrohet në përgatitjen e ligjeve nga lëmi i ekonomisë**

Duke pasur parasysh se ky mandat i Kuvendit është realizuar në rrethana specifike, mandati i parë në kushte të pluralizmit politik, ekonomisë së tregut dhe kompetencave të kufizuara, mendoj se janë arritur rezultate të kënaqshme, por të pamjaftueshme në krahasim me nevojat. E arritura më e madhe është fitimi i përvojës në procedura të nxjerrjes së ligjeve, nxjerrja e një numri ligjesh bazike dhe harmonizimi i përmbajtjes së tyre me standardet evropiane.

Me dinamikën e nxjerrjes së ligjeve në Kuvend në këtë mandat nuk jam krejtësisht i kënaqur, kur kam parasysh nevojën për zëvendësimin e ligjeve nga sistemi i kaluar që vazhdojnë të aplikohen ende. Mirëpo, dinamika e nxjerrjes së ligjeve nuk varet nga kuvendi, por nga organet të cilat duhet të marrim iniciativë për përgatitjen e ligjeve. Dihet se kush e ka këtë obligim, edhe pse nuk përjashtohet mundësia që edhe nga vetë Kuvendi, ose trupat e tij, të përgatiten dhe procedohen për miratim ligje. Ne veçanti, qeveria duhet të përqendrohet në përgatitjen e ligjeve nga lëmi i ekonomisë, ligje të cilat do të krijojnë kushte për zhvillim të papenguar ekonomik.

### **Bajrush Xhemali: Do ta iniciojmë edhe hartimin e projektligjit për miniera...**

Kuvendi i Kosovës nuk mund të krenohet me punën e tij në hartimin e projektligjeve. Puna e bërë në këtë

drejtim është mëse simbolike. Krejt çka është hartuar deri më sot në Kuvend, janë katër projektligje, dhe atë, tri projektligje (pakoja e ligjeve për energjinë), janë hartuar nga Komisioni për Tregti dhe Industri, të cilin e udhëheqi unë, kurse një nga Komisioni për barazi gjinore, të cilin e udhëheq deputetja Melihate Tërnkolli, por që këtë ligj edhe pse është aprovuar në Kuvend nuk e nënshkroi PSPP-ja. Kjo do të thotë se deputetët dhe komisionet nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën për të inicuar dhe hartuar projektligje, në mënyrë që sa më shpejt të plotësohet kuadri ligjor, së paku për fushat më të rëndësishme të jetës.

Me dinamikën e deritashme të projektligjeve, sigurisht që nuk mund të jem i kënaqur. Vetë fakti se Parlamenti mban seancë një apo dy ditë në muaj, tregon mjaft. Parlamenti nuk duhet të presë vetëm nga sponsoruesit dhe hartuesit jashtë Parlamentit, nga Qeveria apo kushdo qoftë, por duhet të shfrytëzojë të drejtën e vet, maksimalisht, për hartimin e projektligjeve, e jo të ankohehet, pa të drejtë, se Qeveria nuk po sjell projektligje në Kuvend. Sigurisht që edhe Qeveria mban pjesën e fajit për neglizhencë e punë të ngadalshme, por Kuvendi njëherë duhet të shikojë se a e ka kryer punën e vet sa e si duhet, e pastaj të gjuajë topin dikund tjetër.

Ne në Komisionin për Tregti dhe Industri, i kemi caktuar prioritetet tona, në vazhdimin e hartimit të projektligjeve. Për ta kompletuar pakon e ligjeve për energjinë, do t'i hartojmë edhe dy projektligje: për ngrohje dhe për gas, e pastaj do ta iniciojmë edhe hartimin e projektligjit për miniera. Në fushën që mbulojmë, ne si Komision, është e ngutshme që sa më shpejt të miratohet edhe Ligji për Koncesionet. Ndërsa në fushat tjera, më kompetentë do të ishin kryetarët tjerë të komisioneve, por unë do të



potenckoja nevojën për ligjin që ka të bëjë me dëshmorët, familjet e tyre, invalidët e luftës dhe statusin e luftëtarit të lirisë, pasi vërtet, këto kategori janë lënë pas dore dhe janë pothuajse pa përkujdesje.

### **Zylfije Hundozi : Të miratohen ligjet për mbajtjen e pacientëve dhe sigurimin shëndetësor**

Të arriturat më të mëdha në hartimin dhe aprovimin e projektligjeve të deritashme në Kuvend janë Kodi Penal dhe ai i Procedurës Penale, Ligji për Shëndetësi etj. Dinamika e nxjerrjes së ligjeve është e kënaqshme. Në fushën e mjekësisë ka ngecje në nxjerrjen e ligjeve. Në këtë lëmë është e domosdoshme që sa më shpejt të hartohen dhe miratohen ligje të tjera, siç janë ligji për mbajtjen e pacientëve dhe i sigurimit shëndetësor.



### **Zehra Elezi: Deri në fund të mandatit pres që në procedurën e Kuvendit të kalojnë edhe 30 ligje.**

Kuvendi i Kosovës deri më tani ka miratuar 43, ndërsa PSSP ka nënshkruar dhe ka shpallur 35 ligje. Në procedurën e Kuvendit gjenden edhe 20 ligje që do të miratohen në seancat e ardhshme të Kuvendit. Deri në fund të mandatit pres që në procedurën e Kuvendit të miratohen edhe 30 ligje të tjera. Të gjitha këto ligje janë hartuar në bazë të normave evropiane dhe standardeve botërore dhe zbatimi i tyre praktik dhe konsekuent do t'u krijojë siguri qytetarëve si dhe e hap rrugën për integrim evropian të Kosovës. Sipas mendimit tim të arriturat më të mëdha në fushën e hartimit dhe të





miratimit të ligjeve është pranimit i shqyrtimit dhe i debatit në Kuvend, pastaj dialogu dhe shkëmbimi i mendimeve në komisione funksionale, parashtrimi i amendamenteve, me çka legjislacioni do ta arrinte ekuilibrin politik, ku shprehet kundërshtimi i ideve ndërmjet parlamentarëve dhe subjekteve politike. Në këtë mënyrë në Kuvend hapen debate për çështje thelbësore dhe në bazë të diskutimeve mund të gjenden zgjidhje të mira për zbatim të mëtejshëm.

Jam e kënaqur që po nxirren dhe po miratohen ligjet. Të gjitha ligjet kanë përparësi edhe pse mendoj se disa ligje është dashur më heret të miratohen si psh.: Ligji për diskriminim dhe Ligji për mbrojtjen e konsumatorit që janë në procedurën e miratimit në Kuvend.

Sa i përket çështjes së miratimit të ligjeve, që sipas mendimit tim duhet të miratohen sa më parë propozoj që të miratohet Ligji për

### **Mahir Yagcilar : Ligjet tona domosdo duhet të jenë të harmonizuara me ato të Bashkësisë Evropiane**

Në kuadër të rezultateve të deritashme, që nuk janë të vogëla, projektligjet e propozuara që janë përgatitur në bazë të parimeve dhe procedurave demokratike dhe me vlerësimin e komisioneve të



Kuvendit, janë për tu çmuar. Në disa komisione siç është ai për transport dhe telekomunikacion, projektligjet kanë kaluar përmes debatit publik, janë vlerësuar nga ana e ekspertëve dhe më në fund e kanë marrë formën në komisionin përkatës. Pas gjithë këtyre procedurave, në formën më të mirë të tyre i janë dorëzuar Komisionit funksional.

Me keqardhje, ligjet të cilat deritash janë miratuar, qoftë për shkak të mangësive apo edhe për arsye të mosnjohjes së fushës përkatëse kanë

ndikuar në mosefikasitetin ligjor. Në të vërtetë është e nevojshme që pas miratimit të ligjeve, të përcillet zbatimi i tyre. Ligjet është e nevojshme që herë pas herë të vlerësohen dhe sipas nevojës edhe t'iu nënshtrohen ndryshimeve. Sipas mendimit tim, për tu realizuar kjo është e nevojshme të vendoset një bashkëpunim më i fortë midis niveleve komunale dhe qendrore të udhëheqjeve.

Nëse mirret parasysh se Kuvendi i Kosovës është ende i ri në pikëpamje të ekzistencës së tij si dhe demokracija shumë partiake, por edhe organizimi shumë partiak është në fazën fillestare, por edhe mosekzistimi i hapësirës së mjaftueshme për punën e deputetëve, dinamika e deritashme e miratimit të ligjeve është më tepër se e suksesëshme. Krahas përmirësimit të bazës për punën e Kuvendit dhe kushteve të deputetëve, do të përmirësohet edhe dinamika e përgjithshme e Kuvendit.

Me miratimin e një numri më të madh të ligjeve në të ardhmën, edhe Kuvendi do të jetë i detyruar të angazhohet edhe më tepër.

Periodha para nesh, është mjaftë e rëndësishme për Kosovën, sepse krahas Dokumentit për standardet, pas zgjidhjes së statusit final të Kosovës meqë dëshirojmë të kyçemi në Bashkësinë Evropiane, ligjet tona domosdo duhet të jenë të harmonizuara me ato të Bashkësisë Evropiane.

Për stabilitetin dhe begatinë e vendit është me rëndësi që të zhvillohemi ekonomikisht dhe të forcohemi financiarisht, duhet të jemi vetëkritik, pastaj të zvogëlohen përqindjet e doganave, të miratohen sa më parë ligjet, që sigurojnë investime më të mëdha dhe më shumë vende të reja pune.

Që të mund të integrohemi në Bashkësinë Evropiane dhe të mos na përsëriten problemet që janë në rrjedhë, është e nevojshme të nxirret edhe Ligji mbi përdorimin e gjuhëve. Me ndërtimin e objekteve të banimit dhe shtëpive si dhe ndarjen e kredive, pastaj edhe ligjet mbi

sistemin bankar duhet gjithashtu sa më parë të përgatiten dhe të miratohen.

Krahas ligjeve për ndërtim planifikim dhe ambient jetësor, duhet të nxirren edhe ligjet mbi ruajtjen e objekteve historike me prioritet, pastaj ligjet për sigurinë në punë, për sigurinë shëndetësore, sigurinë pensionale si dhe për të drejtat tjera të punëtorëve, të cilat duhet të mbrohen me ligj që është shumë e rëndësishme për të gjithë ne.

### **ANËTARËT E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË KOMUNITETEVE VIZITUAN LYPIANIN DHE JANJEVËN**

## **Përpjekje që mësimi të zhvillohet në shkolla të përbashkëta**

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve i Kuvendit të Kosovës, vizitoi Kuvendin Komunal të Lypianit dhe qytezën e Janjevës. Anëtarët e këtij komisioni në qendër të vëmendjes kishin pozitën e minoriteteve në këtë anë, sidomos pas trazirave të 17 dhe 18 marsit. Gjatë bisedës së zhvilluar me strukturat udhëheqëse të Komunës, të prira nga Xhevat Olluri, u tha se në këtë komunë nga afro 85 mijë banorë sa ka gjithsej, 8 mijë janë serbë, 2 mijë hshkalinj dhe romë dhe 400 kroatë. Deri në ngjarjet e 17 dhe 18 marsit në përfshirjen e komuniteteve në të gjitha segmentet e jetës dhe të institucioneve ishin arritur rezultate të kënaqshme, por pas këtyre trazirave të komuniteti serb shfaqet tendenca e tërheqjes nga institucionet, si dhe një mosbesim në lëvizje. Subjektet komunale bëjnë përpjekje të vazhdueshme që integrimi i serbëve dhe i të gjitha komuniteteve tjera të bëhet në të gjitha institucionet, por kjo varet shumë edhe nga vetë vullneti i tyre.

Janë të pranishme në këtë anë edhe raste të mësimi në lokale të ndara, megjithë përpjekjet që bëhen që mësimi të zhvillohet në shkolla të përbashkëta. Pas një pune me përkushtim është arritur marrëveshja që në qytetin e Lypianit të ndërtohet një shkollë e përbashkët, për të cilën janë të nevojshme 160 mijë euro, ndërsa deri tash janë siguruar 150 mijë sosh.


# Është krijuar baza ligjore, hulumtohen rrugët e sigurimit të mjeteve

*Në bazë të studimit të kryer nga "Roughton-International" del se nevojat vjetore për mirëmbajtje të rrjetit ekzistues janë 14,275,000 euro, ndërsa për nevojat të Rehabilitimit të rrugëve ekzistuese magjistrale dhe regionale nevojten 48,103,000 euro. - Është me rëndësi të posaçme zhvillimi i infrastrukturës rrugore të nivelit të autostradave transballkanike, sepse Kosova nuk është e lidhur me asnjë korridor të transportit Ballkanik*

Zhvillimi i mëtejshëm ekonomik i Kosovës është ngusht i lidhur me ngritjen e infrastrukturës rrugore. Mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese dhe ngritja e rrugëve të reja sipas standardeve bashëkohore vështrohet me të drejtë si një nga shtyllat më të rëndësishme të ecjes përpara në të gjithë lëmenjtë ekonomikë. Duke nder këtë, si Qeveria, ashtu edhe Kuvendi i Kosovës, kanë ndërmarë hapa për të vënë në binarë këtë segment jetësor të së tashmes dhe të së ardhmes së Kosovës, duke krijuar edhe bazën ligjore në bazë të së cilës do të zhvillohej infrastruktura rrugore. Kuvendi i Kosovës tashmë ka aprovuar Ligjin për rrugët, i cili tashmë ka hyrë në fuqi, ndërsa ka miratuar edhe Ligjin për Transport rrugor në janar të këtij viti, për të cilin ka paraqitur mocion koalicioni "Kthimi ", ndaj ende nuk është nëshkruar . Për ndriçimin e këtyre çështjeve biseduam me drejtoreshën e Drejtorisë së Rrugëve të Kosovës, **Kaqusha Jashari** dhe udhëhëqësin e Departamentit të infrastrukturës rrugore, në Ministrinë e Transportit dhe Postë- Telekomunikacionit, **Ramë Qupeva**.

Në pyetjen si reflektohet Ligji për rrugët në lëmin e infrastrukturës rrugore në Kosovë, a është e rregulluar mirë çështja e rrugëve me dispozitat ligjore në fuqi, Kaqusha Jashari thekson se Ligji për rrugët është aprovuar në maj të vitit 2003. Me anë të ligjit është bërë kategorizimi i rrugëve në rrugët magjistrale dhe rajonale, për të cilën Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit e ka përgjegjësinë, si dhe të rrugëve lokale me përgjegjësi të kuvendeve komunale. Me ligjin në fjalë janë përfshirë të gjitha segmentet e administrimit rrugor në përgjithësi, por në bazë të tij duhet të nxirren urdhëresat administrative, të cilat rregullojnë dhe konkretizojnë lëmenjtë e veçantë, siç janë: transporti i jashtëzakonshëm, pagesat e kompensimit të shfrytëzimit të brezit rrugor, matja e ngarkesave boshtore dhe gabariti i automjeteve transportuese, të cilat ende nuk janë nxjerrë nga MTPT-ja.

Me Udhëzimin Administrativë mbi Drejtorinë e Rrugëve, i cili është nxjerrë nga MTPT, është caktuar



përgjegjësia për implementimin e kontratave për mirëmbajtje, rehabilitim dhe ndërtim të rrugëve, kurse segmenti i inspektimit pranë Ministrisë për rrugët duhet të formohet.

Ndërkaq, në pyetjen nga cilat burime financohet asfaltimi i rrugëve të reja dhe meremetimi i tyre, a mjaftojnë mjetet ekzistuese për ndërtimin e rrugëve sipas nevojave më akute dhe në çfarë mënyre mendoni të gjeni një zgjidhje afatgjate të financimit të ndërtimit të rrugëve, Kaqusha Jashari thekson se mirëmbajtja verore dhe dimërore, rehabilitimi dhe sinjalizimi, si dhe ndërtimi i rrugëve rajonale dhe magjistrale financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, mirëpo dhe ato mjete nuk janë mjete të mjaftueshme. Gjatë tri vjetëve pas luftës, mirëmbajtja dhe rehabilitimi janë realizuar nga donacionet ndërkombëtare, në bazë të Grant Projektit, ku ka qenë e përfshirë edhe asistencë teknike për Drejtorinë e Rrugëve. Në të ardhmen nuk mund të priten donacione, por duhet të sigurohen burime vetjake për vetë veprimtarinë, ashtu si në vendet e tjera. Të ardhurat duhen të sigurohen nga kompensimet e caktuara prej shitjes së derivateve të naftës dhe gazit, kompensimet për shfrytëzimin e rrugës, shfrytëzimit të brezit rrugor, transportit të jashtëzakonshëm etj.

Përkritazi me këtë Ramë Qupeva saktëson se rrjeti i rrugëve magjistrale dhe regjionale të Kosovës ka 1934 kilometra , nga të cilat 647 km. rrugë magjistrale, 1287 rrugë regjionale, si dhe 256 ura në rrjetin

rrugor, i cili është nën Kompetencat e Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit. Me anë të këtij Ligji definohet mjaft qartë përgjegjësitë si dhe detyrat e MTPT-së, por edhe të kuvendëve komunale, por ky Ligj paraqet një Kornizë në bazë të së cilës më Legjislacionin sekondar do të plotësohen edhe çështjet tjera ligjore, që kanë të bëjnë me infrastrukturën rrugore. Deri me tani MTPT-ja ka aprovuar edhe Urdhëresën Administrative lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Rrugëve, ndërsa Urdhëresa administrative për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e brezit rrugor është e gatshme dhe së shpejti pritet edhe nënshkrimi i saj, thotë Ramë Qupeva.

### **Nuk ka pasur mundësi të realizohen investime kapitale në ndërtimin e rrugëve të reja**

Duke folur rreth pyetjes se çfarë është perspektiva e ndërtimit të rrugëve në rrethanat ekzistuese ligjore e materiale për të krijuar një infrastrukturë të mirëfilltë në Kosovë, e cila do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës, por edhe të inkuadrimit të saj në rrjetin evropian rrugor, Kaqusha Jashari shfaq shpresën se në të ardhmen do t'u kushtohet më shumë rëndësi planifikimit dhe projektimit të rrugëve, si të mirëmbajtjes ashtu edhe të ndërtimeve të reja. Në bazë të strategjisë së zhvillimit ekonomik duhet të harmonizohet edhe strategjia e zhvillimit të rrjetit rrugor. Është me rëndësi të posaçme zhvillimi i infrastrukturës rrugore të nivelit të autostradave transballkanike, sepse Kosova nuk është e lidhur me asnjë korridor të transportit Ballkanik. Për ne është më i rëndësishëm korridori Durrës – Kukës – Prishtinë – Merdare.

Ndërtimi i rrugëve të reja si dhe rehabilitimi i rrugëve ekzistuese magjistrale dhe regjionale bëhet kryekëput nga mjetet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, vë në pah Ramë Qupeva. Ndarja e mjeteve financiare nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për Infrastrukturën rrugore deri me tash është bërë në varshmëri nga shuma e mjeteve të Buxhetit, por jo në bazë të nevojave reale dhe i ka plotësuar vetëm një pjesë të vogël të nevojave për investime në infrastrukturën rrugore.

Duke pasur parasysh mungesën e mjeteve të nevojshme financiare kemi qenë të detyruar që të kufizohemi vetëm në mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues rrugor dhe nuk ka pasur mundësi që të kryhen investime kapitale për rrugët e reja. Kundruall faktit që mënyra e tanishme e financimit të infrastrukturës rrugore nuk garanton siguri dhe kualitet, MTPT-ja bashkë me Bankën Botërore ka kryer studimin lidhur me mënyrën e mëtutjeshme të financimit të infrastrukturës rrugore, si dhe për shumën që shfrytëzuesit e infrastrukturës duhet të paguajnë për shfrytëzimin e

**Pa burime të sigurta nuk mund të planifikohet as mirëmbajtja e rëndomtë e rrugëve e as ndërtimet e reja. Me ligjin mbi rrugët është ndarë përgjegjësia në bazë të kategorizimit të rrugëve, por në rastet kur paraqitet pjesëmarrja e financimit nga komuniteti dhe Kuvendet Komunale për rrugët lokale, Ministria e Transportit merr pjesë në financimin edhe të rrugëve lokale pa marrë parasysh se ato janë përgjegjësi të komunave, thekson Kaqusha Jashari.**

rrjetit rrugor.

Në bazë të këtij studimi të kryer nga “Roughton-International” del se nevojat vjetore për Mirëmbajtje të rrjetit ekzistues janë 14,275,000 euro, ndërsa për nevoja të rehabilitimit të rrugëve ekzistuese magjistrale dhe regjionale nevojten 48,103,000 euro. Propozim tjetër nga ky studim është edhe formimi i Bordit të Rrugëve dhe Fondit për Rrugë, në mënyrë që të sigurohen fondet e nevojshme dhe mirëmbajtja e rregullt e rrugëve magjistrale dhe regjionale, pohon Qupeva.

### **Korridori Merdare- Prizren – Durrës kondierohet si një tërësi**

Lidhur me atë se sa janë angazhuar subjektet kosovare në projektin e ndërtimit të autostradës Merdare-Prizren – Durrës, Kaqusha jashari thotë se për këtë korridor është bërë studimi i arsyeshmërisë ekonomike dhe teknike nga grupi punues i ekspertëve të ndryshëm i organizuar nga Drejtoria e Rrugëve.

Në bazë të këtij studimi Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit ka shpallur tender për projektim të segmentit të korridorit në Kosovë dhe tani është faza e zgjedhjes së firmës projektuese. Pas zgjedhjes së projektimit duhet të kordinohen aktivitetet institucionale në Kosovë dhe Shqipëri për harmonizimin e kushteve projektuese, sepse korridori duhet të konsiderohet si një tërësi. Sikur që ekziston konsensusi politik i të dy palëve për nevojën e korridorit, i cili do të mundësojë zhvillimin ekonomik stabil të rajonit, po ashtu nevojitet edhe konsensusi i përbashkët për çështje profesionale teknike. Kisha për të cekur edhe atë se Ligji për koncesion i cili është në fazën e hartimit dhe aprovimit, do të mundësojë realizimin më të shpejtë të këtij projekti, thotë Kaqusha Jashari .

Përkitazi me këtë çështje Ramë Qupeva , thekson se ky projekt do të financohet nga mjetet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, ndërsa sa i përket ekzekutimit dhe ndërtimit mbetet që institucionet kosovare në bashkëpunim edhe me entitetet financiare Ndërkombëtare, apo edhe përmes koncesionit të punojnë që Projekti më i rëndësishëm i Infrastrukturës Rrugore të realizohet, pasi që Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nuk ka mundësi të financimit.

**Shefqet REXHEPI**

# Evidenca e ligjeve të proceduara dhe të miratuara në Kuvendin e Kosovës

Nr.	Emërtimi i projektligjit	Sponzoruesi	Nr. dhe data e pranimit	Dt.shpërndarjes deputetëve	Shqyrtimi i parë	Shqyrtimi i dytë	Nr. dhe data e miratimit	Dt. dërgimit PSSP	Rreg. nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
1.	Ligji themelor i pensioneve	Qeveria e Kosovës	2002/1 03.06.2002	14.06.2002	27.06.2002	04.07.2002	2002/1 04.07.2002	08.07.2002	2002/15 26.07.2002
2.	Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm	-/-	2002/2 20.06.2002	24.06.2002	11.07.2002	25.07.2002	2002/2 25.07.2002	18.10.2002	2002/19 31.10.2002
3.	Ligji për arsimin e lartë	-/-	2002/3 20.06.2002	24.06.2002	11.07.2002	25.07.2002	2002/3 25.07.2002	18.10.2002	2003/14 12.05.2003
4.	Ligji për hipotekat	-/-	2002/4 26.08.2002	27.08.2002	26.09.2002	17.10.2002	2002/4 17.10.2002	21.10.2002	2002/21 20.12.2002
5.	Ligji për rregullimin e regjistruar për drejtën pronësore	-/-	2002/5 05.09.2002	11.09.2002	26.09.2002	17.10.2002	2002/5 17.10.2002	21.10.2002	2002/22 20.12.2002
6.	Ligji mbi aktivitetet e tregtisë me jashtë	-/-	2002/6 16.09.2002	17.09.2002	10.10.2002	27.11.2002 08.05.2003	2002/6 08.05.2003	06.12.2002 09.05.2003	2003/15 12.05.2003
7.	Ligji për telekomunikacionin	-/-	2002/7 02.10.2002	16.10.2002	31.10.2002	04.12.2002 08.05.2003	2002/7 08.05.2003	10.12.2002 09.05.2003	2003/16 12.05.2003
8.	Ligji për mbrojtjen e ambientit	-/-	2002/8 02.10.2002	11.10.2002	31.10.2002	16.01.2003	2002/8 16.01.2003	10.02.2003	2003/9 15.04.2003
9.	Ligji për inspektoratin e punës	-/-	2002/9 08.10.2002	18.10.2002	07.11.2002	19.12.2002	2002/9 19.12.2002	10.02.2003	2003/4 21.02.2003
10.	Ligji për Pyjet e Kosovës	-/-	2002/10 29.10.2002	30.10.2002	04.12.2002	13.02.2003	2003/3 13.02.2003	25.02.2003	2003/6 20.03.2003
11.	Ligji për menaxhimin e financave publike	-/-	2002/11 19.12.2002	19.12.2002	09.01.2003	23.01.2003 08.05.2003	2003/2 08.05.2003	10.02.2003 09.05.2003	2003/17 12.05.2003
12.	Ligji për faqirat e Kosovës	-/-	2003/1 10.01.2003	10.01.2003	13.02.2003	20.03.2003	2003/5 20.03.2003	25.03.2003	2003/10 15.04.2003
13.	Ligji për likuidimin dhe rirregullimin e personave juridikë	-/-	2003/2 15.01.2003	16.01.2003	13.02.2003	13.03.2003	2003/4 13.03.2003	25.03.2003	2003/7 14.04.2003

Nr.	Emërtimi i projektligjit	Sponzoruesi	Nr. dhe data e pranimit	Dt.shpërndarjes deputetëve	Shqyrtimi i parë	Shqyrtimi i dytë	Nr. dhe data e miratimit	Dt. dërgimit PSSP	Rreg. nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
14.	Ligji për vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme	Qeveria e Kosovës	2003/3 16.01.2003	17.01.2003	27.03.2003	17.04.2003	2003/8 17.04.2003	23.04.2003	2003/12 26.06.2003
15.	Ligji për bibliotekat	-/-	2003/4 21.01.2003	22.01.2003	27.02.2003	04.04.2003	2003/6 04.04.2003	11.04.2003	2003/19 23.06.2003
16.	Ligji për kindën arkivore dhe arkivat	-/-	2003/5 21.01.2003	22.01.2003	27.02.2003	17.04.2003	2003/7 17.04.2003	23.04.2003	2003/20 23.06.2003
17.	Ligji për kooperativat bujqësore	-/-	2003/6 14.03.2003	17.03.2003	17.04.2003	15.05.2003	2003/9 15.05.2003	19.05.2003	2003/21 23.06.2003
18.	Ligji për rrugët	-/-	2003/7 27.03.2003	28.03.2003	24.04.2003	29.05.2003	2003/11 29.05.2003	06.06.2003	2003/24 27.06.2003
19.	Ligji për plehërat artificiale	-/-	2003/8 04.04.2003	07.04.2003	24.04.2003	22.05.2003	2003/10 22.05.2003	26.05.2003	2003/22 23.06.2003
20.	Kodi Penal i Kosovës	UNMIK Qeveria e Kosovës	2003/9 11.04.2003	11.04.2003		08.05.2003		12.05.2003	2003/25 06.07.2003
21.	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës	UNMIK Qeveria e Kosovës	2003/10 11.04.2003	11.04.2003		08.05.2003		12.05.2003	2003/26 06.07.2003
22.	Ligji për qasjen në dokumentet zyrtare	Qeveria e Kosovës	2003/11 05.05.2003	06.05.2003	22.05.2003	26.06.2003	2003/12 26.06.2003	17.10.2003	2003/32 06.11.2003
23.	Ligji për regjistrimin e popullsisë ekonomike familjare, ....	-/-	2003/12 05.05.2003	06.05.2003	22.05.2003	11.07.2003	2003/16 11.07.2003	15.12.2003	
24.	Ligji për prokurimin publik në Kosovë	-/-	2003/13 06.05.2003	07.05.2003	29.05.2003	11.09.2003	2003/17 15.01.2004	21.01.2004	2004/3 09.02.2004
25.	Ligji për ndrysh. e plotësimit të Ligjit 2002/3 për krijim. e Regjistrit të pronës	-/-	2003/14 06.05.2003	07.05.2003	29.05.2003	26.06.2003	2003/13 26.06.2003	16.07.2003	2003/27 18.08.2003
26.	Ligji për planifikimin hapësor	-/-	2003/15 07.05.2003	08.05.2003	05.06.2003	03.07.2003	2003/14 03.07.2003	16.07.2003	2003/30 10.09.2003
27.	Ligji për skemën e ndihmës sociale	-/-	2003/16 07.05.2003	08.05.2003	05.06.2003	11.07.2003	2003/15 11.07.2003	25.07.2003	2003/28 18.08.2003
28.	Ligji për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale	-/-	2003/17 04.06.2003	05.06.2003	18.09.2003	04.12.2003	2003/26 04.12.2003	27.01.2004	
29.	Ligji për naftën dhe derivatet e naftës	-/-	2003/18 12.06.2003	12.06.2003	26.06.2003 i abuzi këtu Qeveria	/	/	/	/
30.	Ligji për shërbimet postare	-/-	2003/19 20.06.2003	20.06.2003	11.07.2003	09.10.2003	2003/18 09.10.2003	04.11.2003	2003/37 17.12.2003
31.	Ligji për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit e ambientit të punës	-/-	2003/20 24.06.2003	01.07.2003	04.09.2003	09.10.2003	2003/19 09.10.2003	15.10.2003	2003/33 06.11.2003



Nr	Emërtimi i projektligjit	Sponzoruesi	Nr. dhe data e pranimit	Ditshpërndarjes deputetëve	Shqyrtimi i parë	Shqyrtimi i dytë	Nr. dhe data e miratimit	Ditë dërgimit PSSP	Rreg.nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
12.	Ligji për ndrysh e plotësime të Ligjit të 2002/9 për inspektorat të punës	Qeveria e Kosovës	2003/21 24.06.2003	30.06.2003	04.09.2003 Nën mbikëqim	/	/	/	/
13.	Kodi doganor i Kosovës	UNMIK Qeveria e Kosovës	2003/22 24.06.2003	27.06.2003		11.07.2003		14.07.2003	Si Rregullorë e UNMIK-ut 2004/1 20.05.2004
14.	Ligji për pensionet e afësisë së kufizuar	Qeveria e Kosovës	2003/23 03.07.2003	04.07.2003	11.09.2003	06.11.2003	2003/23 06.11.2003	19.11.2003	2003/40 17.12.2003
15.	Ligji për inspektoratin sanitar	./.	2003/24 03.07.2003	07.07.2003	18.09.2003	06.11.2003	2003/22 06.11.2003	19.11.2003	2003/39 17.12.2003
16.	Ligji për ndrysh e plotësime të Ligjit të 2003/2 për menaxh. financ. publl.	./.	2003/25 24.07.2003	25.07.2003	25.09.2003	23.10.2003	2003/21 23.10.2003	06.11.2003	2003/38 17.12.2003
17.	Ligji për pesticidet	./.	2003/26 05.09.2003	08.09.2003	25.09.2003	16.10.2003	2003/20 16.10.2003	06.11.2003	2003/35 08.12.2003
18.	Ligji për sportin	./.	2003/27 24.09.2003	26.09.2003	16.10.2003	20.11.2003	2003/24 20.11.2003	03.12.2003	
19.	Ligji kundër diskriminimit	./.	2003/28 26.09.2003	30.09.2003	30.10.2003	19.02.2004	2004/3 19.02.2004	Mocion "Kthimi"	
10.	Ligji për barazim gjinor	Komisioni për barazim gjinor	2003/29 29.09.2003	30.09.2003	23.10.2003	19.02.2004	2004/2 19.02.2004	25.02.2004	
11.	Ligji për kodastër	Qeveria e Kosovës	2003/30 08.10.2003	10.10.2003	23.10.2003	04.12.2003	2003/25 04.12.2003	14.01.2004	2004/4 18.02.2004
12.	Ligji për shëndetësi	./.	2003/31 16.10.2003	17.10.2003	13.11.2003	19.02.2004	2004/4 19.02.2004	Mocion "Kthimi"	
13.	Ligji për transport rrugor	./.	2003/32 29.10.2003	30.10.2003	20.11.2003	15.01.2004	2004/1 15.01.2004	Mocion "Kthimi"	
14.	Legjislativi për bashkëpunimin me Tribunalin Penal të Hagës	./.	21.11.2003	21.11.2003	18.12.2003	19.02.2004	19.02.2004	Mocion "Kthimi"	
15.	Ligji për Odën Ekonomike	./.	2003/33 24.11.2003	26.11.2003	11.12.2003	28.04.2004	2004/7 28.04.2004	10.05.2004	
16.	Ligji për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2004	./.	2003/34 26.11.2003	27.11.2003	04.12.2003	22.12.2003	2003/27 22.12.2003	23.12.2003	Si Rregullorë e UNMIK-ut 2004/1 21.12.2003
17.	Ligji për tregti me nafte dhe derivatet e saj	./.	2003/35 03.12.2003	05.12.2003	22.01.2004	17.03.2004	2004/5 17.03.2004	29.03.2004	
18.	Ligji për Kinematografinë e Kosovës	./.	2003/36 30.12.2003	30.12.2003	22.01.2004				

Nr	Emërtimi i projektligjit	Sponzoruesi	Nr. dhe data e pranimit	Ditshpërndarjes deputetëve	Shqyrtimi i parë	Shqyrtimi i dytë	Nr. dhe data e miratimit	Ditë dërgimit PSSP	Rreg.nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
19.	Ligji për materialin fidancor	Qeveria e Kosovës	2004/1 12.01.2004	13.01.2004	01.04.2004	29.04.2004	2004/13 29.04.2004	10.05.2004	
20.	Ligji për transportin e malrave të rrezikshme	./.	2004/2 22.01.2004	23.01.2004	19.02.2004	01.04.2004	2004/6 01.04.2004	15.04.2004	
21.	Ligji për vepimtaritë hoteliere dhe turistike	./.	2004/3 11.02.2004	13.02.2004	01.04.2004				
22.	Ligji për ndërmarrjet	./.	2004/4 11.02.2004	16.02.2004	01.04.2004				
23.	Ligji për Parkun Nacional Beshkët e Nemuna	./.	2004/5 23.02.2004	25.02.2004					
24.	Ligji për energjinë	Komisioni për tregti e industri	2004/6 02.03.2004	03.03.2004	01.04.2004	29.04.2004	2004/8 29.04.2004	20.05.2004	
25.	Ligji për rregullatorin e Energjisë	./.	2004/7 02.03.2004	03.03.2004	01.04.2004	29.04.2004	2004/9 29.04.2004	20.05.2004	
26.	Ligji për energjinë elektrike	./.	2004/8 02.03.2004	03.03.2004	01.04.2004	29.04.2004	2004/10 29.04.2004	20.05.2004	
27.	Ligji për njësitë matëse	Qeveria e Kosovës	2004/9 03.03.2004	04.03.2004	01.04.2004	29.04.2004	2004/11 29.04.2004	20.05.2004	
28.	Ligji për standardizim	./.	2004/10 03.03.2004	04.03.2004	01.04.2004	29.04.2004	2004/12 29.04.2004	10.05.2004	
29.	Ligji për marrëveshjet ndërkombëtare financiare	./.	2004/11 03.03.2004	04.03.2004	01.04.2004	06.05.2004	2004/14 06.05.2004	10.05.2004	
30.	Ligji për mbrojtjen e konsumatorit	./.	2004/12 02.04.2004	06.04.2004	29.04.2004				
31.	Ligji për ndërtimin	./.	2004/13 13.04.2004	14.04.2004	29.04.2004				
32.	Ligji për veterinarinë	./.	2004/14 21.04.2004	23.04.2004					
33.	Ligji për gatishmërinë emergjente civile	./.	2004/15 23.04.2004	27.04.2004					
34.	Ligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve	Kom. për arsim, shkollë, kulturë	2004/16 14.05.2004	14.05.2004					
35.	Ligji për tatimin në të ardhura personale	Qeveria e Kosovës	2004/17 14.05.2004	14.05.2004					
36.	Ligji për tregtinë e brendshme	./.	2004/18 14.05.2004	14.05.2004					

Nr	Emërtimi i projektligjit	Sponzoruesi	Nr. dhe data e pranimit	Ditshpërndarjes deputetëve	Shqyrtimi i parë	Shqyrtimi i dytë	Nr. dhe data e miratimit	Ditë dërgimit PSSP	Rreg.nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
37.	Ligji për koncesionet	./.	2004/19 14.05.2004	14.05.2004					
38.	Ligji për tatimin në fitim	./.	2004/20 19.05.2004	20.05.2004					





Prizreni